



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 21

Tiranë – E martë, 4 shkurt 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 29.1.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 173, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024” 1943
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 10, datë 27.1.2025	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2024–2025..... 1954
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 12, datë 30.12.2024	Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale..... 1955
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 1705, datë 30.1.2025	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare..... 1966
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 281, datë 18.12.2024	Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “MET Albania” sh.a., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 1966
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 282, datë 18.12.2024	Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “MET Albania” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 1967
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 283, datë 18.12.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike 1968
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 284, datë 18.12.2024	Mbi miratimin e metodologjisë së përcaktimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme..... 1970
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 285, datë 18.12.2024	Mbi përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 79, datë 2.5.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k.” 1985

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 13, datë 16.1.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	1986
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 16.1.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Samasol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	1988
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 16.1.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Rebesol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	1990
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 16, datë 16.1.2025	Mbi përlogaritjen e mbështetjes financiare që duhet të dokumentojnë në ERE subjektet që aplikojnë për t’u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike.....	1992
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 17, datë 16.1.2025	Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar në muajin tetor 2024 nga parku fotovoltaiik “Blue 1” i shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k.....	1993
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 18, datë 16.1.2025	Mbi kërkesën e shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 15.11.2024.....	1994
	Korrigjim gabimi material në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 30.12.2024, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 225, datë 30.12.2024.....	1996



VENDIM
Nr. 68, datë 29.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 173, DATË 24.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE 2023–2030, PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ, SI DHE PLANIT TË ZBATIMIT TË GARANCISË RINORE 2023–2024”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 173, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024”, bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe në pikën 1, periudha “2023–2024” zëvendësohet me “2023–2025”;

2. Në shtojcën 3, në të gjithë tekstin e planit të zbatimit të garancisë rinore bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Periudha “2023–2024” zëvendësohet me “2023–2025”;

b) Fjalët “... skemës në vitin 2023 ...” zëvendësohen me “... skemës në vitin 2023–2025 ...”;

c) Fjalët “... fund të vitit 2023 ...” zëvendësohen me “... fund të vitit 2025 ...”;

ç) Fjalët “... për vitin 2024 ...” zëvendësohen me “... për vitin 2025 ...”;

d) Fjalët “... në vitin 2024 ...” zëvendësohen me “... në vitin 2025 ...”;

dh) Në pikën 2, të pjesës B, të planit të zbatimit të garancisë rinore, fjalët “... fundi i vitit 2026 ...” zëvendësohen me “... fundi i vitit 2025 ...”.

3. Tabelat 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 17, që pasqyrojnë reformat e nismat kryesore në përmbushje të planit të zbatimit të garancisë rinore, zëvendësohen me tabelat me të njëjtët numra dhe tituj të përfshirë në aneksin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS
REFORMAT DHE MASAT E PLANIFIKUARA TË PLANIT TË ZBATIMIT TË GARANCISË RINORE

Tabela 6. Reformat dhe nismat kryesore për të identifikuar grupet e synuara, shërbimet aktuale dhe nevojat për aftësi, si dhe për parandalimin përmes gjurmimit dhe sistemeve të paralizimit të hershëm

Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit
Reformat e planifikuara					
Futja e treguesve shtesë në AFP për karakterizim më të mirë të të rinjve JAPFP	Karakterizim i hollësishëm dhe periodik i të rinjve JAPFP, përfshirë variabla që mundësojnë ndërhyrje të hershme të përshtatur sipas karakteristikave individuale të secilit të ri	Kampion statistikisht përfaqësues i popullsisë 15–29 vjeç.	Kombëtar	INSTAT-i	Identifikimi i treguesve të munguar gjatë 2025-s. Futja e tyre në AFP si pilotim 2025-n. Anketë periodike më 2024-n.
Ngritja e një sistemi për të vlerësuar tendencat e tregut të punës (1)	Të orientohen nxënësit në AFP dhe arsim të lartë, si edhe të përcaktohen kualifikimet që ofrohen në këto nivele arsimore.	Të rinjtë në arsim dytësor Oferta AFP dhe FP	Kombëtar	MEKI AKPA-ja/AKAFPK-ja	Reformë afatmesme Metodologjia dhe instrumentet kryesore hartohen gjatë 2025-s



Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit
(i referohet zhvillimit të sistemit, prandaj është prezantuar si reformë)					
Vlerësimi përmblledhës i sistemit të informacionit të AKPA (PES)	Mbështetje në planifikimin e miratimit të treguesve EMCO dhe monitorimin dhe vlerësimin e YG-së Strukturimi i një udhëzuesi metodologjik specifik për të mbështetur zbatimin e YG-së	Qeverisja e GR-së. Të rinjtë në arsimin e mesëm Oferta e AFP-së dhe FP-së	Kombëtar	MEKI Reforma afatshkurtër e AKPA-së	Vlerësimi përmblledhës dhe metodologjia që do të zhvillohet gjatë fazës pilot (2025)
Nismat e planifikuara					
Përgatitja e një vlerësimi vjetor të profileve JAPFP në Shqipëri	Të përditësohet periodikisht karakterizimi i të rinjve bazuar në treguesit që do të integrohen në modulën statistikor në AFP	Kampion statistikisht përfaqësues i popullsisë 15–29 vjeç	Kombëtar	INSTAT-i	Nga T1 2025 si projekt pilot, referuar të dhënave nga anketa 2024 Anketë periodike që nga 2025-a
Përdorimi i sistemit të hapur të regjistrimit paraprak JAPFP – Portali GR – që do të përgatitet në fazën e komunikimit, që të mbledhë informacion vullnetar shtesë për të rinjtë JAPFP Do të bazohet në një portal <i>on-line</i> të dedikuar për garancinë rinore Sistemi i regjistrimit paraprak duhet të integrohet në platformën JAPFP Kjo nismë mund të integrohet në databazën e parashikuar nga ligji për rininë që, sipas MSRK-së, po ndërtohet	Qëllimi është të mbledhet informacion shtesë për të njohur më mirë popullsinë JAPFP Shumica e këtij informacioni nuk mbledhet nga AFP-ja (p.sh. udhët individuale në shkollë dhe tregun e punës; preferencat për ofertat; aftësitë transversale relevante që mungojnë) Ky objektivi do të mbështetet nga Sistemi i Regjistrimit Paraprak të të rinjve JAPFP të identifikuar nga partnerët vendorë të përfshirë në strategjinë e komunikimit. Ky portal është instrument i strategjisë së komunikimit, i identifikuar në atë fazë Në fakt, përveç identifikimit të të rinjve, sistemi informatik mund të mbledhë informacion shtesë mbi veçoritë social-ekonomike dhe formimin arsimor të të rinjve JAPFP, duke mundësuar harmonizim më të mirë të shërbimeve dhe përgjigjeve në kuadrin e garancisë rinore në një fazë të mëvonshme	Popullsia JAPFP 15–29 vjeç	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Agjencia Kombëtare e Rinisë	Gjatë 2025-s, përgatitja e platformës informatike (faqe interneti me databazë) Platforma pilotohet në T2 të 2024-s Funksion periodik nga 2025-a
Përshkallëzimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të pilotuar, që është testuar tashmë. Ky sistem monitorimi vlerëson rrezikun e ngeljes dhe të braktisjes së shkollës pas arsimit të detyrueshëm (2) Përshkallëzimi ka dy faza: i. zbatim i disa projekteve pilot; ii. zgjerimi gradual i mbulimit të sistemit	Të monitorohen rezultatet shkollore dhe variablat e tjerë për të përcaktuar performancën shkollore Në këtë drejtim, është e rëndësishme të hartohen e të zbatohen programe për të ndihmuar nxënësit në rrezik braktisjeje	Identifikohen nxënësit e dy shkollave: një në zonë urbane dhe një në zonë rurale	Vendor	MAS-i Drejtorja e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Arsimit ASCAP-i Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar	Projektet pilot më 2025-n Përshkallëzim gradual nga 2026-a e në vazhdim. Zbatimi fillon në vitin shkollor 2026–2027
Ofrimi i programeve të nxënies që ndihmojnë	Të identifikohen lëndët, ku ka rezultate më të dobëta dhe braktisje, si dhe të hartohen	Të rinjtë në shkollat të mesme	Kombëtar	MAS-i	Hartimi i programeve të të nxënësve gjatë 2025-s



Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit
nxënësit në rrezik braktisjeje Programet e nxënies do të testohen nga projektet pilot dhe pas rregullimeve periodike do të ofrohen në sistem	programe të shkurtra rikuperimi për ta			Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Arsimit ASCAP Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar	në harmoni me projektet pilot Zbatimi fillon në vitin shkollor 2026–2027
Vlerësimi i zbatimit të masave të mbështetjes sociale për të reduktuar pengesat në aksesin në sistemin AFP Të jepen bursa për nxënësit e rrezikuar, duke shfrytëzuar fondet që MAS-i ua jep bashkëve	Të reduktohet risku i braktisjes së hershme të shkollës në arsimin dytësor, për shkak të nevojave ekonomike të të rinjve	Të rinjtë në AFP që përballen me vështirësi /privim ekonomik	Kombëtar	MEKI Agjencia Kombëtare e Punësimit MAS-i Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Arsimit DPAP-ja Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar MSHMS-ja Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki	Gjatë 2025-s
Përforsimi i këshillimit dhe orientimit në AFP (kryesisht pas arsimit të detyrueshëm)	T'u ofrohen të rinjve JAPFP këshillim mbi nevojat për trajnim dhe orientim për karrierë	Të rinjtë 15–29 të regjistruar në garancinë rinore	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Bashkitë OJF-të	Fundi i 2025-s dhe përforsim gradual gjatë 2026-s
Forcimi kapaciteteve për orientim për karrierë në arsim Kjo nismë hartohet me qëllimin që të reduktohet braktisja e hershme e shkollës	Të përmirësohen shërbimet e orientimit për karrierë dhe të ndihmohen nxënësit që të bëjnë zgjedhje të zgjuara në udhët e nxënies Orientimi për karrierë është mjet i dobishëm për të parandaluar braktisjen e shkollës. Gjithashtu, rit pjesëmarrjen në kurset AFP	Të rinjtë që ndjekin sistemin AFP	Kombëtar	MEKI AKPA-ja dhe AKAPFK-ja-ja MAS-i Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Arsimit DPAP-ja Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar	Gjatë 2025-s
Pilotimi i zbatimit të integruar të disa mjeteve të vlerësimit për të identifikuar nevojat e tregut të punës: kualifikimet që kërkon dhe mundësitë për punë që ofron (lidhet me reformën më lart dhe lidhet me zbatimin sistematik (që fillon me pilotim) të analizës së tregut të punës. Prandaj, këtu paraqitet si nismë)	Të identifikohen aftësitë dhe kualifikimet që kërkon tregu i punës dhe punësueshmëria e kurseve që ofrohen në arsimin dytësor dhe të lartë	Mjet global i tregut të punës.	Kombëtar	AKPA-ja dhe AKAPFK-ja	Më 2025-n, zhvillimi metodologjik Më 2025-n, pilotimi për të nisur zbatimin sistematik



Tabela 7. Reformat dhe nismat kryesore për të garantuar komunikimin efektiv dhe gjithëpërfshirës

Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostot e zbatimit (nëse ka) dhe burimi i financimit
Reformat e planifikuara						
Ndryshime ligjore në kuadrin legjislativ (akte nënligjore) për grantet e organizatave rinore	Të krijohet një mekanizëm granti që financon organizatat rinore, që marrin pjesë në rrjetet vendore të komunikimit Këto grante duhet të mbështetnin organizatat rinore në kryerjen e detyrave të informimit dhe aktivizimit Mobilizimi dhe koordinimi i organizatave rinore brenda këtij rrjeti duhet të jetë përgjegjësi e organizatës kombëtare të rinisë, që duhet të marrë pjesë në zbatimin e mekanizmit të grantit	Organizatave rinore	Kombëtar, rajonal vendor	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Agjencia Kombëtare e Rinisë	2024–2025, ndryshimet legjislative	Kostoja direkte e pavarësuar
Konsolidimi i rrjetit të Këshillave Vendorë të Rinisë dhe të pajisja e tyre me kapacitetet e nevojshme për të ushtruar kompetencat	Të vihen në funksion këshillat vendorë të rinisë dhe të miratohen aktivitetet e rrjetit vendor të këtyre këshillave	Bashkitë, organizatat rinore, të rinjtë	Vendor	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët	Pilotimi i angazhimit të një ose dy këshillave vendorë të rinisë në zhvillimin e strategjisë së komunikimit deri në fund të shtatorit Gjysma e KVR-ve bëhen funksionale në kontekstin e GR deri në dhjetor 2023 Të tjerët gjatë 2024-s	15.000 €
Nismat e planifikuara						
Fushatë komunikimi kryesisht në mediat sociale (hartuar në kuadrin e strategjisë së komunikimit GR)	Për të rinjtë JAPFP, synimet e strategjisë së komunikimit janë kryesisht: - motivimi që të veprojnë - bërja e ditur e mundësive - orientimi përmes sistemit	Të rinjtë	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit AKPA-ja Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Agjencia Kombëtare e Rinisë	T1 i 2025-s, përgatitja e planit të komunikimit dhe e materialeve Zbatohet gjatë T2 të 2025-s	125.000 €
Portali “Për rininë” parashikuar në ligjin për rininë si strategji kryesore komunikimi on-line në kuadrin e PZGR-së (Portali GR përfshihet edhe në fazën e hartëzimit, përshkruar më lart)	Të zhvillohet në mjet komunikimi on-line në kontekstin e zbatimit të GR. Të mbështetet strategjia e komunikimit, duke dhënë informacion për masat dhe partnerët e përfshirë në GR dhe të lejohet regjistrimi i të rinjve në program. Portali GR duhet të jetë pjesë thelbësore e strategjisë së komunikimit	Popullata JAPFP 15–29 vjeç	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Agjencia Kombëtare e Rinisë	2025, përgatitja e platformës informatike (faqe interneti me databazë) Faza pilot në 6-mujorin e parë të 2025 Funksionim i rregullt që nga gjashtëmujori i dytë i 2025-s	Kostoja e përcaktuar tashmë në fazën e hartëzimit



Emërtimi i reformës/nismës	Objektivi/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostot e zbatimit (nëse ka) dhe burimi i financimit
Trajnim i rrjetit vendor	Të zhvillohen aftësitë dhe burimet e partnerëve vendorë që t'u mundësohet zbatimi i strategjive të komunikimit Njohuri për GR-në, programet e saj, portalin, sistemin e regjistrimit dhe ofrimi i kurseve të shkurtra mbi aftësitë e buta të të rinjve – janë disa prej çështjeve për t'u pasur parasysh	Bashkitë, organizatat rinore, të rinjtë	Rajonal e vendor	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Rinisë	T1 i 2025 (mbështetja e funksionimit të plotë të gjysmës së këshillave vendorë të rinisë, në kuadrin e GR në 2025-n)	47.500 €
Programi i kontratës së komunikimit	Sinjalizimi, regjistrimi dhe informimi i të rinjve JAPFP të kontraktohen te aktorët vendorë: bashkitë dhe organizatat rinore	Bashkitë, organizatat rinore, të rinjtë	Rajonal e vendor	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Rinisë	Fundi i 2026-s	1.575.000 €

Tabela 8. Reformat dhe nismat kryesore të fazës përgatitore

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivi/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostot e zbatimit (nëse ka) dhe burimi i financimit
Reformat e planifikuara						
Reformimi i kriterëve të pranueshmërisë lidhur me zbatimin e programeve për ndërtimin e punësimit (në proces tashmë)	Të lejohet AKPA-ja të ofrojë shërbime punësimit për të rinjtë e papunë pasi regjistrohen	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar në AKPA, si JAPFP	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	T1 i 2024	Kostoja direkte e pavlerësuar
Ngritja e një rrjeti shërbimesh këshillimi dhe orientimi – “sportele të hapura” – që menaxhohen në partneritet me AKPA-s, bashkive dhe OJF-ve (Realizohet në kuadrin e këshillave vendorë të rinisë, sipas rolit të tyre në strategjinë e komunikimit Të përfshihen punonjësit rinorë)	T'u ofrohet të rinjve JAPFP këshillim mbi nevojat për trajnim dhe orientim për karrierë	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar në garancinë rinore	Rajonal e vendor	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Bashkitë OJF-të	Fundi i 2025-s	Kostoja direkte e pavlerësuar
Forcimi i kapaciteteve të AKPA-s, duke zhvilluar aftësitë e personelit (sipas përshkrimeve të reja të punës në proces hartimi nga SREPVEI) dhe mija e numrit të burimeve njerëzore	Të pajiset AKPA-ja me kapacitete të duhura që të zbatojë aktivitetet lidhur me menaxhimin dhe shërbimet e garancisë rinore Kjo përfshin kapacitete për procedura standarde për kontraktim të shërbimeve/partnerëve dhe monitorimin	Personeli i AKPA-s	Kombëtare, rajonale e vendore	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2024	105.000 €

Tabela 9. Reformat dhe nismat kyçe për fazën përgatitore

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivi/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostot e zbatimit (nëse ka)
Nismat e planifikuara						
Trajnimi i personelit të zyrave vendore dhe rajonale të AKPA-s, bashkive dhe OJF-ve	Të trajnohet personeli vendor për këshillimin dhe orientimin sipas “sporteleve të hapura” dhe me aftësitë për vlerësim nevojash	Personeli teknik i zyrave vendore dhe rajonale të AKPA-s, bashkive dhe OJF-ve	Rajonal e vendor	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët	Gradualisht gjatë 2024-s e 2025-s	105.000 €



Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostot e zbatimit (nëse ka)
Portali GR (parashikuar në strategjinë e komunikimit)	individuale dhe këshillim karriere T'u ofrohet të rinjve informacioni kryesor për garancinë rinore dhe shërbimet e saj. Të lejohen të rinjtë JAPFP të regjistrohen për të marrë shërbime GR.	Personeli teknik i zyrave vendore dhe rajonale të AKPA-s, bashkive dhe OJF-ve	Rajonal e vendor	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Gradualisht gjatë 2025-s	Kostoja direkte e pavlerësuar
Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)	T'u lejojnë të rinjve informacioni dhe akses të informacionit të plotë rreth tyre.	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar në garancinë rinore Shkollat	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Fundi i 2025-s	Për vlerësuar t'u
Udhëzim metodologjik, që mbështet këshillimin dhe orientimin sipas JAPFP	Të ofrohet një instrument që ndihmon në punën e personelit vendor, që merret me këshillimin dhe orientimin në “sportelet e hapura” Të përshtatet këshillimi dhe orientimi sipas profileve JAPFP (shih raportin e hartëzimit)	Personeli teknik i zyrave vendore të AKPA-s, bashkive dhe OJF-ve	Rajonal e vendor	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Gjashtëmujori i dytë i 2025-s	30.000 €
Ofrimi i trajnimeve të shkurtra mbi aftësitë e punësueshmërisë (aftësi për kërkim pune, aftësi të buta për tregun e punës, aftësi digjitale)	Të përgatiten/përditësohen programet e trajnimit sipas nevojave specifike të JAPFP të ndryshëm Të përshtatet oferta për trajnim sipas profileve të ndryshme JAPFP (shih raportin e hartëzimit)	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar në AKPA si JAPFP	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Zbatimi gjatë 2025-s	780.000 €

Tabela 10. Reformat dhe nismat kryesore për ofertat e garancisë rinore

Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostot e zbatimit, nëse ka (a)
Nismat e planifikuara						
Rishikimi i rregullores AFP që të rinjtë mbi 21 vjeç të hyjnë dhe të rihyjnë në ofertën AFP	Të bëhet më tërheqëse oferta AFP dhe të rritet numri i të rinjve, që ndjekin këtë udhë në shkollën e mesme	Të rinjtë 15 – 29 vjeç pa arsim dytësor	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	Gjashtëmujori i parë i 2025-s	Kostoja direkte e pavlerësuar
Rishikimi i strukturës aktuale AFP që të shmanget matura shtetërore profesionale për nxënësit, që nuk duan të vazhdojnë në arsimin e lartë, por synojnë të gjejnë punë. Të krijohet një certifikim autonom (ndryshim i pikës 4/b, të nenit 16 – rishikim i ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”)	Të bëhet më tërheqëse oferta AFP dhe të rritet numri i të rinjve që ndjekin këtë udhë në shkollën e mesme.	Të rinjtë 15-29 vjeç pa nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	Gjashtëmujori i parë i 2025-s	Kostoja direkte e pavlerësuar
Zgjerimi i ofertës së kurseve profesionale pas e mesme të nivelit 5 të kualifikimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Kurse 1-vjeçare, si për maturantët e shkollave të përgjithshme dytësore dhe të shkollave profesionale, dhe të rinj të tjerë të interesuar.	Të diversifikohet oferta AFP dhe të krijohet një udhë alternative mes arsimit dytësor të lartë dhe arsimit të lartë. T'u jepet të rinjve JAPFP me arsim dytësor një udhë alternative që të	Të rinjtë 15–29 vjeç me nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	Fillon në vitin shkollor 2025–2026 dhe zgjerohet gradualisht	150.000 €



Emërtimi i reformës/nismës	Objektivi/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostot e zbatimit, nëse ka (a)
Nismat e planifikuara						
Rishikimi dhe mbështetja e sistemit me kohë të pjesshme të MAS-it për studentët, që kanë kaluar moshën për shkollë të mesme (duhet për aftësi të buta, orientim për karrierë si pjesë e këtij programi)	përftojnë një kualifikim profesional. Të bëhet AFP më tërheqëse					
Qëllimi për të zgjeruar ofertën e nivelit 5 duhet të përfshijë rishikimin e programeve aktuale të formimit	Të diversifikohet oferta AFP dhe të krijohet një udhë alternative mes arsimit dytësor të lartë dhe arsimit të lartë Të bëhet AFP më tërheqëse	Të rinjtë 15–29 vjeç me nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Gjatë 2025-s	Kostoja vlerësuar sipër e më
Vlerësim ndikimi tërësor i politikave aktive të tregut të punës	Të vlerësohet performanca e ofertave GR dhe të mbështetet rishikimi e përditësimi i politikave aktive të tregut të punës	Të rinjtë 15–29 vjeç me shkollë të mesme	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	Fundi i 2025-s	112.500 €
Ngritja e sistemit të nxënies në punë brenda sistemit të sektorit AFP	Të diversifikohet oferta e formimit profesional dhe të përforcohet sistemi i kualifikimeve, duke afruar kompani që ofrojnë trajnime. Të reduktohet braktisja e hershme e shkollës, duke ofruar udhë kualifikimi të diversifikuara Sistemi që do të ngrihet do të jetë program i shkurtër nxënieje në punë (6-mujor) me objekt të kufizuar pa adresuar për momentin kuadrin evropian të cilësisë	Të rinjtë 15–29 vjeç pa nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Ministria e Arsimit dhe Sportit AKPA-ja / AKAPFK-ja	Ngritja e grupit të punës që të hartojë modalitetet e duhura për rregullimin, koordinimin dhe organizimin e ofertës së nxënies në punë: fundi i 2023-shit Faza pilot fillon në 2025-n për një cikël nxënieje 3-vjeçar	15.000 €
Vlerësimi i nevojave për ta zgjeruar ofertën e për ta bërë më tërheqëse Zbatimi i masave dhe forcimi i programit për shansin e dytë	Të lejohen të rinjtë që kanë braktisur herët shkollën, që të përfundojnë arsimin me anë të trajnimeve të certifikuara plotësuese (kjo u referohet kryesisht të rinjve pa arsim bazë ose të mesëm)	Të rinjtë që kanë braktisur herët shkollën pa arsim të nivelit bazë apo dytësor	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Fundi i 2023-shit	7.215.000 €
Ngritja e kapaciteteve të AKPA-s nëpërmjet zhvillimit të aftësive të personelit (artikulluar me përkrahjet e reja të punës në zhvillim nga SREPVET-i) dhe rritja e numrit të burimeve njerëzore (shih artikullimin me reformën në fazën përgatitore)	Të përforcohet aftësia e AKPA-s që të menaxhojë zbatimin e programeve të punësimit	Personeli i AKPA-s	Kombëtare rajonale, vendore	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2025	Kostoja direkte e pavlerësuar
Arsimi dhe formimi profesional i vazhdueshëm	Trajnime të diversifikuara, që adresojnë certifikimin e rezultateve të nxënies në arsimin bazë dhe dytësor (si i përgjithshëm edhe AFP) që të rinjtë të përfundojnë arsimimin e ndërprerë	Të rinjtë 15–29 vjeç pa nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	Fundi i 2023-shit	6.000.000 €



Tabela 11. Reformat dhe nismat kyçe për ofrimin e ofertave të garancisë rinore

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivi(at) kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostot e zbatimit, nëse ka (a)
Nismat e planifikuara						
Rritja e ofertave të programit të praktikave profesionale. Të hapet aksesimi për grup të synuar më të gjerë. (1)	Të mbështetet kalimi të rinjve në tregun e punës.	Të rinjtë e sapodiplomuar të regjistruar si JAPFP në zyrat e punës.	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi	Në linjë me shpalljen e GR-së	4.037.500 €
Programi Kombëtar i Praktikave Profesionale, thirrja e 7-të do të administrohet nga MSHRF-ja (6 thirrjet e tjera i administroi MAS-i). Mundësi për të rinjtë 21-26 vjeç që kanë përfunduar të paktën ciklin e parë të studimeve <i>bachelor</i> , që të bëjnë praktikë pune 3-mujore në institucione qendrore dhe vendore, biznese, OJF etj. (MSHRF)	Të mbështetet kalimi të rinjve në tregun e punës	Të rinjtë e sapodiplomuar me të paktën nivelin <i>bachelor</i> të regjistruar si JAPFP në zyrat e punës.	Kombëtar	MSHRF	Në linjë me shpalljen e GR-së	617.500 €
Programi i punësimit	Të mbështetet kalimi i të rinjve në tregun e punës, duke përputhur vendet e lira me profilin e punëkërkuar.	Të rinjtë 15-29 vjeç të regjistruar si JAPFP në zyrat e punës.	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Në linjë me shpalljen e GR-së	4.500.000 €
Trajnimi në punë	Të mbështetet punësimi i të rinjve përmes trajnimit që adreson kualifikimet e kërkuara për profesione specifike dhe që përputhen me nevojat e punëdhënësve.	Të rinjtë 15-29 vjeç të regjistruar si JAPFP në zyrat e punës.	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Në linjë me shpalljen e GR-së	1.276.500 €
Programi i vetëpunësimit	Të nxitet vetëpunësimi	Të rinjtë 15-29 vjeç të regjistruar	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë,	Në linjë me	1.299.800 €



	duke krijuar <i>start-up</i> -e.	si JAPFP në zyrat e punës.		Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	shpalljen e GR-së	
Mbështetje financiare për romët dhe kategori të tjera vulnerabël si emigrantët. Programe bursash për nxënësit e shkollave të mesme (pas arsimit të detyrueshëm, përfshi AFP) nga familje në vështirësi ekonomike.	Të nxitet aksesi në arsim për të rinjtë nga kategoritë vulnerabël.	Të rinjtë 15-29 vjeç	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	Gjatë 2025-s	1.750.000 €
Kurset e formimit profesional Oferta duhet t'u japë përparësi aftësive emergjente transversale (si aftësive digjitale) dhe sektorëve ekonomikë relevantë (si turizmi).	Të përforcohen aftësitë e punësueshmërisë së të rinjve nëpërmjet trajnimeve të shkurtra të përshtatura me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë e punës që kërkohen.	Të rinjtë 15-29 vjeç pa nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit AKPA/AKAP FK	Duke filluar në 2025-n	1.625.000 €
Kurse të shkurtra AFP nga 3 në 12 muaj, organizuar në module.	Të përforcohen aftësitë e punësueshmërisë së të rinjve, që përshtaten me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për punë që kërkohen. T'u jepet mundësia të rinjve JAPFP pa arsim dytësor, që të marrin një kualifikim përmes një udhe fleksibël.	Të rinjtë 15-29 vjeç pa nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Gjatë 2025-s, përcaktim i i portofolit bazë. Edhe testimi i kurseve të reja. Gradualisht fillohet me zgjerimin e ofertës nga 2025 e tutje.	1.300.000 €
Kurset AFP (Rritja e ofertës AFP)	Të rritet niveli arsimor i të rinjve dhe t'u jepet një kualifikim për të mbështetur kalimin e tyre në tregun e punës.	Të rinjtë 15-29 vjeç pa nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	Fillon në vitin shkollor 2025-2026 dhe zgjerohet gradualisht	6.500.000 €



	Të sillen më shumë nxënës në AFP duke rritur arritjet arsimore në arsimin dytësor dhe artikulim (harmonizim) me nevojat e tregut të punës.			Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive		
Kurset e nxënies në punë	Të rritet kualifikimi i të rinjve dhe të forcohet artikulimi i trajnimit me kërkesën e tregut të punës për të mbështetur kalimin në tregun e punës.	Të rinjtë 15-29 vjeç pa nivel arsimor dytësor	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	Faza pilot fillon në 2025 për një cikël nxëniesje 3-vjeçar.	7.800.000 €
Mbështetja e ndërmarrjeve sociale të vogla për të rinjtë e burgosur, duke filluar nga periudha e vuajtjes së dënimit për zhvillimin e aftësive profesionale të të rinjve përmes kurseve profesionale për përgatitjen për tregun e punës (në aspektin agrokulturor, instalimeve, në fushën e ndërtimit, turizmit etj.) ²⁰ .	Të rinjtë e burgosur	Personat e burgosur në moshën 14-29 vjeç	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Faza pilot fillon në 2025 për një cikël nxëniesje 3-vjeçar.	Për kurset profesionale brenda institucionit penal 500.000 euro

Tabela 17. Reformat dhe nismat që do të jenë pjesë e projektit pilot

Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit
Reformat e planifikuara					
Reformimi i kriterëve të pranueshmërisë lidhur me zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit	Të lejohet AKPA-ja të ofrojë shërbime punësimi për të rinjtë e papunë, pasi regjistrohen	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar në AKPA si JAPFP	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Pilotim 2025
Nismat e planifikuara					
Trajnimi i rrjetit vendor	Të zhvillohen aftësitë dhe burimet e partnerëve vendorë që t'u mundësohet zbatimi i strategjive të komunikimit	Bashkitë, organizatat rinore, të rinjtë	Rajonal e vendor	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Rinisë	Pilotim 2025



Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit
	Njohuri për GR, programet e saj, portalin, sistemin e regjistrimit dhe ofrimi i kurseve të shkurtra mbi aftësitë e buta të të rinjve – janë disa prej çështjeve për t'u pasur parasysh.				
Programi i kontratës së komunikimit	Sinjalizimi, regjistrimi dhe informimi i të rinjve JAPFP të kontraktohen te aktorët vendorë: bashkitë dhe organizatat rinore	Bashkitë, organizatat rinore, të rinjtë	Rajonal e vendor	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Rinisë	Pilotim 2025
Përf forcimi i këshillimit dhe orientimit në AFP (kryesisht pas arsimit të detyrueshëm)	T'u ofrohen të rinjve JAPFP këshillim për nevojat për trajnim dhe orientim për karrierë	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar në garancinë rinore	Rajonal e vendor	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Bashkitë OJF-të	Pilotim 2025
Portali për të rinjtë	Hartimi i një mjeti komunikimi në internet si pjesë e zbatimit të GR-së	Të rinjtë 15–29 vjeç /JAPFP	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Agjencia Kombëtare e Rinisë	Zhvillimi i platformës informatike (faqe me bazë të dhënash) 2025 Faza pilot në gjysmën e parë të 2025. Funksionon rregullisht në gjysmën e dytë të 2025.
Ofrimi i trajnimeve të shkurtra mbi aftësitë e punësueshmërisë (aftësi për kërkim pune, aftësi të buta për tregun e punës, aftësi digjitale)	Të përgatiten/përditësohen programet e trajnimit sipas nevojave specifike të JAPFP-ve të ndryshëm Të përshtatet oferta për trajnim sipas profileve të ndryshme JAPFP (shih raportin e hartëzimit)	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar në AKPA si JAPFP	Rajonal e vendor	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Pilotim 2025
Rritja e ofertave të Programit të Praktikave Profesionale Të hapet akses për grup të synuar më të gjerë (1)	Të mbështetet kalimi i të rinjve në tregun e punës	Të rinjtë e sapodiplomuar të regjistruar si JAPFP në zyrat e punës	Rajonal e vendor	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Pilotim 2025
Programi i punësimit	Të mbështetet kalimi i të rinjve në tregun e punës, duke përputhur vendet e lira me profilin e punëkërkuar	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar si JAPFP në zyrat e punës	Rajonal e vendor	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Pilotim 2025
Trajnimi në punë	Të mbështetet punësimi i të rinjve përmes trajnimit, që adreson kualifikimet e kërkuara për profesione specifike dhe që përputhen me	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar si JAPFP në zyrat e punës	Rajonal e vendor	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Pilotim 2025



Emërtimi i reformës/nismës	Objekti/at kyç	Grupi i synuar, përfshi nr. e personave (nëse ka)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit
	nevojat e punëdhënësve				
Programi i Vetëpunësimit	Të nxitet vetëpunësimi duke krijuar <i>start-up</i> -e	Të rinjtë 15–29 vjeç të regjistruar si JAPFP në zyrat e punës	Rajonal e vendor	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Pilotim 2025
Kurse të formimit profesional Oferta t'u ofrojnë përparësi aftësive ndërsektoriale në zhvillim (të tilla si aftësitë digjitale) dhe sektorët përkatës ekonomikë (siç është turizmi)	Forcimi i aftësive të nevojshme për të rinjtë nëpërmjet përmirësimit të punësueshmërisë së tyre përmes kurseve afatshkurtra trajnimi të orientuara sipas nevojave të tregut të punës dhe mundësitë e reja të punës	Të rinjtë 15–29 vjeç pa arsim të mesëm	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/AKAPFK	Pilotim 2025
Kurse të AFP-së (rritjen e ofertës së AFP-së)	Të rrisë nivelin e arsimimit të të rinjve dhe t'u japë atyre një kualifikim për t'i mbështetur në tranzicionin drejt tregut e punës Afrimi i më shumë nxënësve në rrugën e AFP-së, duke rritur arritjet arsimore në nivelin e arsimit të mesëm dhe duke i lidhur këto nevoja me tregun e punës	Të rinjtë 15–29 vjeç pa arsim të mesëm	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Duke filluar nga viti shkollor 2025–2026 dhe më pas zgjerimi gradualisht
Kurse të të nxënët në vendin e punës (<i>apprenticeship</i>)	Përmirësimi i kualifikimeve të të rinjve dhe për të forcuar lidhjen midis trajnimit dhe kërkesës së tregut të punës për të mbështetur tranzicionin në tregun e punës	Të rinjtë 15–29 vjeç pa arsim të mesëm	Kombëtar	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Arsimit Agjencia e Formimit Profesional dhe Kualifikimit	Faza pilot fillon në vitin 2025 për një cikël mësimor trevjeçar

UDHËZIM
Nr. 10, datë 27.1.2025

zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE KOMBËTARE TË
ARSIMIT BAZË, VITI SHKOLLOR
2024–2025**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrat nr. 609, datë 20.12.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë të sesionit të parë, për vitin shkollor 2024–2025 të zhvillohen në datat si më poshtë:

- lënda “Gjuhë shqipe”, më 19 qershor 2025;
- lënda “Matematikë”, më 25 qershor 2025;
- lënda “Gjuhë e huaj” e parë, më 30 qershor 2025;
- lënda “Gjuhë amtare”, për nxënësit e pakicave kombëtare më 20 qershor 2025.



2. Nxënësit e pakicave kombëtare vlerësohen në lëndët: “Gjuhë amtare”, “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe sipas dëshirës edhe në një gjuhë të huaj.

3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 74, datë 15.2.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”.

4. Gjuhët e huaja që do të jepen si provim i detyruar janë: “Anglisht”, “Frëngjisht”, “Italisht” dhe “Gjermanisht”. Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

6. Provimet fillojnë në orën 10:00 dhe çdo provim zgjat 2 orë e 30 minuta.

7. Nxënësit me aftësi të kufizuar që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare të arsimit bazë, sipas përcaktimeve në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë.

8. Drejtuesi i Institutit të nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi” e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.

9. Çdo zyrë vendore e arsimit parauniversitar merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe në QSHA.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit

parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani

UDHËZIM Nr. 12, datë 30.12.2024

MBI OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË INFORMACIONIT TË TRAFIKUT NË KOHË REALE¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 221, pika 3; dhe 222, pika 1, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 77/2, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës ‘Agjenda Kombëtare e reformave 2024–2027’ në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian ‘Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor’”,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Ky udhëzim përcakton specifikimet e nevojshme për të siguruar aksesin, shkëmbimin, ripërdorimin dhe përditësimin e të dhënave ndërmjet mbajtësve të të dhënave dhe përdoruesve të të dhënave për ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale, në Republikën e Shqipërisë. Nëpërmjet këtij udhëzimi sigurohet që, këto shërbime të jenë të sakta dhe të disponueshme brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për përdoruesit fundorë të shërbimeve.

¹ Ky udhëzim është përafëruar pjesërisht me rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2022/670, të datës 2 shkurt 2022, që plotëson direktivën 2010/40/BE të Parlamentit

Evropian dhe të Këshillit në lidhje me ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale në mbarë BE-në. Celex 32022R0670, FZ L 122, 25.4.2022, f. 1–16.



2. Ky udhëzim zbatohet për të gjithë rrjetin rrugor që është publikisht i aksesueshëm për një trafik të motorizuar.

3. Ky udhëzim nuk do të zbatohet për rrugët private, përveç nëse ato janë pjesë e rrjetit gjithëpërfshirës TEN-T apo janë përcaktuar si autostradë, ose si rrugë interurbane kryesore.

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Rrjeti kryesor rrugor transevropian” është infrastruktura e transportit rrugor që është pjesë e rrjetit kryesor transevropian, sikurse është përcaktuar në urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, “Për zbatimin e rregullores ‘Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit’”;

2. “Rrjeti gjithëpërfshirës rrugor transevropian” është infrastruktura e transportit rrugor që është pjesë e rrjetit gjithëpërfshirës transevropian, sikurse është përcaktuar në urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, “Për zbatimin e rregullores ‘Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit’”;

3. “Autostradë” është rruga, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

4. “Aksesueshmëria e të dhënave” është mundësia për të kërkuar dhe marrë të dhënat në çdo kohë në një format digjital të lexueshëm nga një pajisje digjitale, sikurse është përcaktuar në ligjin nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;

5. “Të dhëna statike” janë të dhënat që nuk ndryshojnë shpesh ose në mënyrë të rregullt;

6. “Të dhëna dinamike” janë të dhënat që ndryshojnë shpesh ose rregullisht;

7. “Përditësim i të dhënave” është çdo ndryshim i të dhënave ekzistuese, duke përfshirë fshirjen ose futjen e elementeve të reja ose shtesë;

8. “Informacion i trafikut në kohë reale” është çdo informacion që ofrohet nga çdo e dhënë mbi infrastrukturën, të dhënat mbi rregulloret dhe kufizimet, të dhënat për gjendjen e rrjetit dhe të dhënat për përdorimin në kohë reale të rrjetit ose kombinimi i këtyre të dhënave;

9. “Shërbim informacioni për trafikun në kohë reale” nënkupton një shërbim SIT që u ofron menjëherë përdoruesve fundorë të shërbimeve, informacionin e trafikut në kohë reale;

10. “Autoritet rrugor” është çdo autoritet publik përgjegjës për planifikimin, kontrollin ose menaxhimin e rrugëve që janë në kompetencën e tij funksionale ose territoriale;

11. “Operator rrugor” është çdo subjekt publik ose privat, përgjegjës për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugës dhe/ose menaxhimin e flukseve të trafikut;

12. “Ofrues shërbimi” është çdo subjekt publik ose privat që ofron një shërbim informacioni për trafikun në kohë reale, duke përjashtuar një transferues të thjeshtë të të dhënave tek përdoruesit e të dhënave;

13. “Operator i mbledhjes së tarifës” është çdo subjekt publik ose privat që ofron shërbimin e tarifës ose mbledhësit të tarifave;

14. “Mbajtës i të dhënave” është çdo person juridik, ose privat i cili krijon dhe mbledh të dhëna, si dhe ka të drejtë të lejojë dhënien ose të ndajë llojet e tyre sipas llojeve të përcaktuara në shtojcën 1, të cilat janë nën kontrollin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi për aksesin e drejtë në të dhëna dhe përdorimin e tyre;

15. “Përdorues i të dhënave” është çdo autoritet rrugor, operator rrugor, operator i mbledhjes së tarifës, ofrues shërbimi dhe prodhues hartash digjitale, ose çdo subjekt tjetër që i përdor të dhënat për të krijuar informacion të trafikut në kohë reale ose, kur lejohet nga termat dhe kushtet e përcaktuara nga mbajtësi i të dhënave, i përdor këto të dhëna për qëllime të tjera të lidhura me lëvizshmërinë;

16. “Përdorues fundor i shërbimit” është çdo përdorues rruge, person fizik ose juridik, i cili ka akses në shërbimet e informacionit të trafikut në kohë reale;

17. “Pika e hyrjes” është ndërfaqja digjitale ku të dhënat e përcaktuara në shtojcën 1, së bashku me metadatat përkatëse, bëhen të aksesueshme për ripërdorim nga përdoruesit e të dhënave, ose ku burimet dhe metadat e këtyre të dhënave bëhen të aksesueshme për ripërdorim nga përdoruesit e të dhënave;

18. “Metadata” është përshkrimi i strukturuar i përmbajtjes së të dhënave që lehtëson kërkimin dhe përdorimin e këtyre të dhënave;



19. “Shërbimi për kërkimin e të dhënave” është shërbimi që lejon kërkimin e të dhënave duke përdorur përmbajtjen e metadave përkatëse dhe që shfaqin përmbajtje të tilla;

20. “Masa të përkohshme të menaxhimit të trafikut” janë masat e përkohshme që synojnë të zgjidhin një shqetësim të caktuar të trafikut dhe të projektuara për shembull, për të kontrolluar dhe drejtuar flukset e trafikut;

21. “Plane të qarkullimit të trafikut” janë masat e përhershme të menaxhimit të trafikut, të projektuara nga menaxherët e trafikut për të kontrolluar dhe drejtuar flukset e trafikut në përgjigje të shqetësimeve të përhershme ose të përsëritura të trafikut;

22. “Shenjat e trafikut” është çdo shenjë ose sinjal rrugor, pajisje, njoftim ose shenjzim rrugor që identifikon një rrezik, i këshillon personat për masat paraprake që duhen marrë ndaj një rreziku të tillë, që tregon ekzistencën e një rregulli rrugor ose që zbaton një rregull të tillë, sipas Konventës së Vjenës për Shenjat dhe Sinjalet Rrugore, ratifikuar me ligjin nr. 9142, datë 16.10.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ‘Për shenjat dhe sinjalet rrugore, 8 nëntor 1968’” dhe në protokollin “Për shenjat rrugore, 1 mars 1973”;

23. “Rrugë parësore/kryesore” janë rrugë jashtë zonave urbane që lidhin qytetet ose rajonet kryesore, ose të dyja, të cilat nuk janë klasifikuar si pjesë e rrjetit rrugor gjithëpërfshirës transevropian ose si autostradë;

24. “Rrugë private” është çdo rrugë që nuk është në pronësi të një autoriteti publik rrugor ose transporti, duke përfshirë rrugët në pronësi të një autoriteti publik rrugor ose autoriteti transporti, por që i janë caktuar një subjekti privat në formën e një koncesioni menaxhimi;

25. “Rrugë ushtarake” është çdo rrugë e ndërtuar, mirëmbajtur dhe përdorur ekskluzivisht nga Forcat e Armatosura ose strukturat e tjera ushtarake për qëllime të mbrojtjes kombëtare, stërvitjeve ushtarake apo lëvizjes së pajisjeve dhe personelit ushtarak. Këto rrugë nuk janë të hapura për publikun dhe përdorimi i tyre rregullohet nga autoritetet ushtarake;

26. “Të dhëna mbi infrastrukturën” janë të dhënat që përshkruajnë rrjetin rrugor ose objektet në rrjetin rrugor ose përgjatë tij;

27. “Të dhëna mbi rregullat dhe kufizimet” janë të dhënat që kanë të bëjnë me një rregull trafiku ose

një kufizim të zbatueshëm për automjetet në rrjetin rrugor;

28. “Të dhëna për gjendjen e rrjetit” janë të dhënat që përshkruajnë situata të përkohshme që mund të ndalojnë ose ngadalësojnë udhëtimin ose mund të informojnë përdoruesin fundor të shërbimit, për situata të rrezikshme;

29. “Të dhëna për përdorimin në kohë reale të rrjetit” janë të dhëna që përshkruajnë përdorimin aktual të rrjetit rrugor dhe opsionet e përdorimit në rrjetin rrugor;

30. “Lloje të rëndësishme të të dhënave” janë llojet e të dhënave që konsiderohen thelbësore, në dobi të rritjes së besueshmërisë së shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale, duke mbështetur udhëtimin e sigurt dhe efikas derë më derë dhe shërbimet e lëvizshmërisë në të ardhmen;

31. “Të dhëna të gjeneruara në automjet” është çdo e dhënë e krijuar nga automjeti ose nga një pajisje e vendosur në automjet ose pajisje personale që ofron aplikacione SIT, gjatë përdorimit të automjetit;

32. “Mbajtës i të dhënave të krijuara në automjet” është çdo subjekt i cili kryen mbledhjen, grumbullimin ose lloje të tjera të përpunimit të të dhënave të krijuara në automjet për të përmbushur kërkesat e privatësisë;

33. “Kushte FRAND (të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese)” janë kushtet e licencës, të negociuara në mirëbesim mes mbajtësit të të dhënave dhe përdoruesit, të cilët lejojnë aksesin në shërbime ose të dhëna kundrejt një shpërblimi të drejtë, duke garantuar kushte të njëjta ose të ngjashme për të gjithë përdoruesit.

34. “Sistemet inteligjente të transportit” ose “SIT” nënkuptojnë sisteme në të cilat teknologjitë e informacionit dhe komunikimit aplikohen në fushën e transportit rrugor, duke përfshirë edhe infrastrukturën, mjetet dhe përdoruesit, si dhe në menaxhimin e trafikut, menaxhimin e lëvizshmërisë dhe për ndërfaqen me mënyra të tjera të transportit;

35. NAPCORE është Organizata e Koordinimit të Pikave Kombëtare të Aksesit për Evropën (*National Access Point Coordination Organisation for Europe*).

Neni 3

Pika Kombëtare e Aksesit

1. Autoriteti Rrugor Shqiptar (“ARRSH”) është pika kombëtare e aksesit për përdoruesit e të dhënave të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur



këtij udhëzimi, duke përfshirë përditësimet e të dhënave, të ofruara nga mbajtësit e të dhënave, në përputhje me nenet 4 deri në 11 të këtij udhëzimi, për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. ARRSH-ja jep për përdoruesit e të dhënave të drejtën për të bërë kërkimin e të dhënave të disponueshme, duke përdorur përmbajtjen e metadatave përkatëse dhe duke shfaqur përmbajtje të tilla.

3. ARRSH-ja përcakton pikën e hyrjes digjitale dhe bazën e të dhënave, ku vendosen, paraqiten dhe ruhen metadatat e të dhënave ose edhe vetë të dhënat e ofruara nga mbajtësit e këtyre të dhënave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

4. Mbajtësit e të dhënave publike dhe private ofrojnë metadatat e të dhënave të tyre, tek Autoriteti Rrugor Shqiptar, në mënyrë që të lejojnë përdoruesit e të dhënave të zbulojnë dhe të përdorin grupe të dhënash, nëpërmjet ARRSH-së.

5. Çdo subjekt që, ofron të dhëna nëpërmjet ARRSH-së, mund ta bëjë këtë nëpërmjet një ndërmjetësi në përputhje me marrëveshjet e zbatueshme, për shembull nëpërmjet një baze të të dhënave ose një grumbulluesi të të dhënave, të kontrolluar nga një palë e tretë.

Mbajtësi i të dhënave origjinale është përgjegjës, edhe në këtë rast, për cilësinë e të dhënave origjinale që ofrohen.

6. ARRSH-ja merr masat e nevojshme për të siguruar mbledhjen e të dhënave të SIT, sipas këtij udhëzimi, si dhe legjislacionit në fuqi për SIT dhe kur është e nevojshme bashkëpunon me mbajtësit e të dhënave, për të siguruar këto të dhëna.

Neni 4

Aksesueshmëria, shkëmbimi dhe ripërdorimi i të dhënave në infrastrukturë

1. Autoritetet rrugore, operatorët rrugorë, operatorët e mbledhjes së tarifave dhe subjektet e interesuara për karikimin dhe furnizimin me karburant ofrojnë të dhënat për infrastrukturën, të renditura në shtojcën 1 bashkëlidhur, që ata mbledhin gjatë aktivitetit të tyre, duke synuar ofrimin e shërbimeve të pajtueshme, ndërvepruese dhe të vazhdueshme të informacionit të trafikut në kohë reale.

Të dhënat ofrohen në përputhje me specifikimet e të dhënave gjeohapsinore “INSPIRE” për rrjetet e transportit, sikurse janë përcaktuar me vendimin e

Këshillit të Ministrave nr. 133, datë 20.3.2019, “Për miratimin e dokumentit ‘Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri’”.

Tema: Rrjetet e transportit”, ose ‘TN-SIT’ (DS CEN/TS17268 dhe versionet e përmirësuara vijuese) ose DATEX II (SSH EN 16157-1, SSH EN 16157-2; SSH EN 16157-3; SSH EN 16157-7; SSH EN 16157-4; SSH EN 16157-5; SSH EN 16157-4; SSH EN 16157-5; DS CEN/TS-6; DS CEN/TS16157-10; DS CEN/TS-11; DS CEN/TS 16157-12, sikurse njohur si standard shqiptar (SSH EN 16157-7; SSH EN 16157-1, SSH EN 16157-2, SSH EN 16157-3; DS CEN/TS 16157-6; DS CE/TS 16157-8; DS CEN/TS 16157-9).

Çdo përditësim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me nenin 8, të këtij udhëzimi.

2. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas konsultimit me NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, mund të përcaktojë standarde shtesë ose alternative, me kusht që formatet digjitale të lexueshme nga kompjuteri të jenë në përputhje me standardin ekzistues, të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti Rrugor Shqiptar konsultohet me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, përpara përcaktimit të këtyre standardeve shtesë ose alternative. Informacioni mbi standardin/ standardet shtesë ose alternative, paraqitet i plotë në pikën e hyrjes digjitale.

4. Të dhënat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe metadatat përkatëse, duke përfshirë informacionin mbi cilësinë e tyre, janë të aksesueshme për shkëmbim dhe ripërdorim për çdo përdorues të të dhënave, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, sipas parimeve të mëposhtme:

a) mbi baza jodiskriminuese;

b) duke respektuar kërkesat minimale të cilësisë për të cilat Autoriteti Rrugor Shqiptar ka rënë dakord në bashkëpunim me palët përkatëse të interesuara;

c) brenda një afati kohor që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të të dhënave për të krijuar informacion në kohë reale të trafikut;

ç) nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar.

5. Përdoruesit e të dhënave që, përdorin të dhënat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe mbajtësit e të dhënave, bashkëpunojnë për

korrigjimin e çdo pasaktësie që lidhet me të dhënat. Përdoruesit e të dhënave informojnë pa vonesë mbajtësin e të dhënave nga i cili burojnë të dhënat dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar, për çdo pasaktësi të tyre.

Neni 5

Aksesueshmëria, shkëmbimi dhe ripërdorimi i të dhënave mbi rregullat dhe kufizimet

1. Autoritetet rrugore, operatorët rrugorë dhe operatorët e mbledhjes së tarifave ofrojnë të dhënat mbi rregullat dhe kufizimet, të renditura në shtojcën 1, që ata mbledhin gjatë aktivitetit të tyre, duke synuar ofrimin e shërbimeve të pajtueshme, ndërvepruese dhe të vazhdueshme të informacionit të trafikut në kohë reale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të dhënat ofrohen në formatin DATEX II (SSH EN 16157, SSH EN 16157 dhe versionet e përmirësuara vijuese, sikurse treguar në nenin 4, pika 1, paragrafi i dytë më sipër), ose në formatin TN-SIT (DS CEN/TS 17268 dhe versionet e përmirësuara vijuese).

Çdo përditësim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me nenin 9, të këtij udhëzimi.

2. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas konsultimit me NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, mund të përcaktojë standarde shtesë ose alternative, me kusht që formatet digjitale të lexueshme nga kompjuteri, të jenë në përputhje me standardin ekzistues të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

ARRSH-ja konsultohet me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, përpara përcaktimit të këtyre standardeve shtesë ose alternative. Informacioni mbi standardin/standardet shtesë ose alternative paraqitet i plotë në pikën e hyrjes digjitale.

3. Të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe metadat përkatëse, duke përfshirë informacionin mbi cilësinë e tyre, janë të aksesueshme për shkëmbim dhe ripërdorim për çdo përdorues të të dhënave, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, sipas parimeve të mëposhtme:

- a) mbi baza jodiskriminuese;
- b) duke respektuar kërkesat minimale të cilësisë për të cilat Autoriteti Rrugor Shqiptar ka rënë

dakord në bashkëpunim me palët përkatëse të interesuara;

c) brenda një afati kohor që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të të dhënave për të krijuar informacion në kohë reale të trafikut;

ç) nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar.

4. Përdoruesit e të dhënave që përdorin të dhënat e përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe mbajtësit e të dhënave bashkëpunojnë për korrigjimin e çdo pasaktësie që lidhet me të dhënat. Përdoruesit e të dhënave informojnë pa vonesë mbajtësin e të dhënave nga i cili burojnë të dhënat, dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar, për çdo pasaktësi të tyre.

5. Ofruesit e shërbimeve përpunojnë dhe përfshijnë, në shërbimet përkatëse që ofrojnë, pa kosto shtesë për përdoruesin fundorë të shërbimeve, të dhëna për çdo plan të qarkullimit të trafikut, rregull dhe kufizim të trafikut të zhvilluar nga autoritetet kompetente dhe të bëra të aksesueshme nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar në një format digjital të lexueshëm nga kompjuteri.

Neni 6

Aksesueshmëria, shkëmbimi dhe ripërdorimi i të dhënave për gjendjen e rrjetit

1. Autoritetet rrugore, operatorët rrugorë, mbajtësit e të dhënave të krijuara në automjet dhe ofruesit e shërbimeve do të ofrojnë të dhënat për gjendjen e rrjetit, të renditura në shtojcën 1, që ata mbledhin gjatë aktivitetit të tyre, duke synuar ofrimin e shërbimeve të përputhshme, ndërvepruese dhe të vazhdueshme të informacionit të trafikut në kohë reale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të dhënat ofrohen në formatin DATEX II (SSH EN 16157, SSH EN 16157 dhe versionet e përmirësuara vijuese, sikurse treguar në nenin 4, pika 1, paragrafi i dytë, më sipër).

2. Çdo përditësim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me nenin 10 të këtij udhëzimi.

3. Autoriteti Rrugor Shqiptar pas konsultimit me NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, mund të përcaktojë standarde shtesë ose alternative, me kusht që formatet digjitale të lexueshme nga kompjuteri të jenë në përputhje me standardin ekzistues të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

ARRSH-ja konsultohet me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri përpara përcaktimit të këtyre



standardeve shtesë ose alternative. Informacioni mbi standardin/ standardet shtesë ose alternative paraqitet i plotë në pikën e hyrjes digjitale.

4. Të dhënat e përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe metadatat përkatëse, duke përfshirë informacionin mbi cilësinë e tyre, janë të aksesueshme për shkëmbim dhe ripërdorim për çdo përdorues të të dhënave brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian:

a) mbi baza jodiskriminuese kur ato sigurohen nga autoritetet rrugore dhe operatorët rrugorë;

b) duke respektuar kërkesat minimale të cilësisë për të cilat Autoriteti Rrugor Shqiptar ka rënë dakord në bashkëpunim me palët përkatëse të interesuara;

c) brenda një afati kohor që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të të dhënave për të krijuar informacion në kohë reale të trafikut;

ç) nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar;

d) pa detyruar mbajtësit e të dhënave të krijuara në automjet dhe ofruesit e shërbimeve private që të japin akses ose të ndajnë çdo të dhënë të tyre me përdoruesit e të dhënave private. Shkëmbimi dhe ripërdorimi i të dhënave të tyre do të kryhet në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara nga mbajtësi i të dhënave private.

5. Përdoruesit e të dhënave që përdorin të dhënat e përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe mbajtësit e të dhënave bashkëpunojnë për korrigjimin e çdo pasaktësie që lidhet me të dhënat. Përdoruesit e të dhënave informojnë pa vonesë mbajtësin e të dhënave nga i cili burojnë të dhënat, dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar, për çdo pasaktësi të tyre.

6. Ofruesit e shërbimeve përpunojnë dhe përfshijnë, në shërbimet përkatëse që ofrojnë, pa kosto shtesë për përdoruesin fundorë të shërbimeve, çdo masë të përkohshme të menaxhimit të trafikut të zhvilluar nga autoritetet kompetente dhe të bërë të aksesueshme nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar në një format digjital të lexueshëm nga kompjuteri.

7. Autoriteti Rrugor Shqiptar, duke synuar ofrimin e informacionit të duhur drejtpërdrejt për përdoruesit fundorë të shërbimeve dhe optimizimin e mirëmbajtjes së rrugëve dhe sigurisë rrugore, u kërkon mbajtësve të të dhënave të krijuara në automjet dhe ofruesve të shërbimeve, të ofrojnë llojet e të dhënave për gjendjen e rrjetit që ata mbledhin dhe t'i përditësojnë ato, në përputhje me nenin 10 të këtij udhëzimi.

8. Mbajtësi i të dhënave sipas pikës 7 të këtij neni, i ofron akses Autoritetit Rrugor Shqiptar tek këto të dhëna, në përputhje me kushtet FRAND (të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese). Të dhënat bëhen të aksesueshme në formatin DATEX II (SSH EN 16157, SHSH EN 16157 dhe versionet e përmirësuara vijuese, sikurse treguar në nenin 4, pika 1, paragrafi i dytë më sipër) ose në çdo format digjital të lexueshëm nga kompjuteri, për të cilin është rënë dakord sipas pikës 3 të këtij neni, shoqëruar me metadatat përkatëse, duke përfshirë informacionin për cilësinë e tyre.

9. Të dhënat mbi gjendjen e rrjetit rrugor që janë arkivuar nga autoritetet rrugore ose operatorët rrugorë mund të përdoren për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore dhe vlerësimin e sigurisë rrugore, për të gjithë rrjetin rrugor.

10. Të dhënat mbi gjendjen e rrjetit rrugor që janë arkivuar nga autoritetet rrugore ose operatorët rrugorë, të përmendura në pikën 9 të këtij neni, janë të aksesueshme për shkëmbim dhe ripërdorim, mbi baza jodiskriminuese, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar me përjashtim të rasteve kur kjo ndalohet nga kushtet e marrëveshjeve të licencës.

11. Të dhënat parashikuese për gjendjen e rrjetit, të llogaritura nga autoritetet rrugore ose operatorët rrugorë janë të aksesueshme për shkëmbim dhe ripërdorim, mbi baza jodiskriminuese, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, brenda kufijve të marrëveshjeve të zbatueshme të licencës.

12. Autoriteti Rrugor Shqiptar konsultohet me NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në përcaktimin e standardeve për shkëmbimin dhe ripërdorimin e të dhënave, të përcaktuara në pikat 9, 10 dhe 11, të këtij neni.

13. Autoriteti Rrugor Shqiptar konsultohet me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, përpara përcaktimit të këtyre standardeve. Standardet për shkëmbimin e këtyre të dhënave publikohen në pikën e hyrjes digjitale.

Neni 7

Aksesueshmëria, shkëmbimi dhe ripërdorimi i të dhënave për përdorimin në kohë reale të rrjetit

1. Autoritetet rrugore, operatorët rrugorë, ofruesit e shërbimeve, mbajtësit e të dhënave të krijuara në automjet dhe palët e interesuara të



lidhura me karikimin dhe mbushjen me karburant ofrojnë të dhënat që ata mbledhin, për përdorimin në kohë reale të rrjetit, të renditura në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke synuar ofrimin e shërbimeve të pajtueshme, ndërvepruese dhe të vazhdueshme të informacionit të trafikut në kohë reale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të dhënat ofrohen në formatin DATEX II (SSH EN 16157, S SSH EN 16157 dhe versionet e përmirësuara vijuese, sikurse treguar në nenin 4, pika 1, paragrafi i dytë më sipër).

2. Çdo përditësim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me nenin 11 të këtij udhëzimi.

3. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas konsultimit me NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, mund të përcaktojë standarde shtesë ose alternative, me kusht që formatet digjitale të lexueshme nga kompjuteri të jenë në përputhje me standardin ekzistues të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

ARRSH-ja konsultohet me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri përpara përcaktimit të këtyre standardeve shtesë ose alternative. Informacioni mbi standardin/ standardet shtesë ose alternative paraqitet i plotë në pikën e hyrjes digjitale.

4. Të dhënat e përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe metadatat përkatëse, duke përfshirë informacionin mbi cilësinë e tyre, janë të aksesueshme për shkëmbim dhe ripërdorim për çdo përdorues të të dhënave, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian:

a) mbi baza jodiskriminuese kur ato sigurohen nga autoritetet rrugore dhe operatorët rrugorë;

b) duke respektuar kërkesat minimale të cilësisë për të cilat Autoriteti Rrugor Shqiptar ka rënë dakord në bashkëpunim me palët përkatëse të interesuara;

c) brenda një afati kohor që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të të dhënave për të krijuar informacion në kohë reale të trafikut;

ç) nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar;

d) pa detyruar mbajtësit e të dhënave të krijuara në automjet dhe ofruesit e shërbimeve private që të japin akses ose të ndajnë çdo të dhënë të tyre me përdoruesit e të dhënave private. Shkëmbimi dhe ripërdorimi i të dhënave të tyre do të kryhet në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara nga mbajtësi i të dhënave private.

5. Duke synuar ofrimin e informacionit të duhur drejtpërdrejt për përdoruesit fundorë të shërbimeve dhe optimizimin e menaxhimit të trafikut dhe sigurisë rrugore, autoritetet rrugore dhe operatorët rrugorë mund të kërkojnë nga mbajtësit e të dhënave të krijuara në automjet dhe ofruesit e shërbimeve që të ofrojnë llojet e të dhënave, për përdorimin në kohë reale të rrjetit që ata mbledhin dhe përditësojnë në përputhje me nenin 11 të këtij udhëzimi.

6. Mbajtësi i të dhënave, sipas pikës 5 të këtij neni, i jep akses autoritetit rrugor ose operatorit rrugor në të dhënat e tij, në përputhje me kushtet FRAND (të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese). Të dhënat bëhen të aksesueshme në formatin DATEX II (SSH EN 16157, SSH EN 16157 dhe versionet e përmirësuara vijuese) ose në çdo format digjital të lexueshëm nga kompjuteri, të aprovuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar pas konsultimit me NAPCORE dhe me autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, shoqëruar me metadatat përkatëse, duke përfshirë informacionin për cilësinë e tyre.

7. Të dhënat mbi përdorimin në kohë reale të rrjetit që janë arkivuar nga autoritetet rrugore ose operatorët rrugorë mund të përdoren për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore dhe vlerësimet e sigurisë rrugore për të gjithë rrjetin rrugor.

8. Të dhënat mbi përdorimin në kohë reale të rrjetit që janë arkivuar nga autoritetet rrugore ose operatorët rrugorë të përmendura në pikën 7 të këtij neni, janë të aksesueshme për shkëmbim dhe ripërdorim, mbi baza jodiskriminuese, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, përveç të dhënave që ndalohen të jepen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

9. Të dhënat parashikuese për përdorimin në kohë reale të rrjetit, të përpunuara nga autoritetet rrugore ose operatorët rrugorë janë të aksesueshme për shkëmbim dhe ripërdorim, mbi baza jodiskriminuese, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, përveç të dhënave që ndalohen të jepen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

10. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas konsultimit me NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në përcaktimin e standardeve për shkëmbimin dhe ripërdorimin e të dhënave të përcaktuara në pikat 7, 8 dhe 9, të këtij neni.



Autoriteti Rrugor Shqiptar konsultohet me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri përpara përcaktimit të këtyre standardeve. Standardet për shkëmbimin e këtyre të dhënave publikohen në pikën e hyrjes digjitale.

Neni 8

Përditësimi i të dhënave për infrastrukturën

1. Përditësimi i të dhënave për infrastrukturën përfshin parametrat e mëposhtëm:

a) llojin e të dhënave të përcaktuara në pikën 1, të shtojcës 1, që lidhet me përditësimin;

b) vendndodhjen e situatës me të cilën lidhet përditësimi;

c) llojin e përditësimit (modifikim, shtim ose fshirje);

ç) përshkrimin e përditësimit që përmban vlerën/vlerat dhe fushën/fushat e përditësuara dhe informacionin e përditësuar dhe aty ku është relevante, arsyet për zëvendësimin e vlerës/vlerave dhe fushës/fushave të vjetruara;

d) datën e përditësimit të të dhënave;

dh) datën dhe orën kur ka ndodhur ose është planifikuar të ndodhë ndryshimi në një situatë të caktuar;

e) cilësinë e përditësimit të të dhënave, sikurse përcaktuar në kërkesat e cilësisë, të aprovuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas konsultimit paraprak me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

2. Vendndodhja e situatës, për të cilën bëhet përditësimi, përcaktohet duke përdorur një metodë të standardizuar ose çdo metodë tjetër të përdorur gjerësisht dhe të pranuar përgjithësisht, të referimit të vendndodhjes dinamike që mundëson dekodimin dhe interpretimin plotësisht të qartë të kësaj vendndodhjeje.

3. Mbajtësit përkatës të të dhënave përditësojnë të dhënat mbi infrastrukturën brenda një afati kohor që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të të dhënave, në shërbimet e informacionit të trafikut në kohë reale dhe aty ku dihet dhe është e mundur, ia ofrojnë paraprakisht këto përditësime përdoruesve të të dhënave.

4. Mbajtësit përkatës të të dhënave korrigjojnë, në kohën e duhur, çdo pasaktësi të zbuluar prej tyre në të dhënat e tyre ose të sinjalizuar tek to, nga çdo

përdorues i të dhënave dhe çdo përdorues të shërbimeve i të dhënave.

5. Prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve të hartave digjitale që, ofrojnë informacion për përdoruesit fundorë të shërbimeve, i përpunojnë përditësimet përkatëse të të dhënave për infrastrukturën, brenda një afati kohor të përshtatshëm për përdorimin e besueshëm dhe efektiv të të dhënave në shërbimet e informacionit të trafikut në kohë reale.

Neni 9

Përditësimi i të dhënave për rregullat dhe kufizimet

1. Përditësimi i të dhënave për rregullat dhe kufizimet përfshin të paktën parametrat e mëposhtëm:

a) llojin e të dhënave të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të shtojcës 1, që lidhet me përditësimin;

b) vendndodhjen e situatës me të cilën lidhet përditësimi;

c) llojin e përditësimit (modifikim, shtim ose fshirje);

ç) përshkrimin e përditësimit, duke përfshirë periudhën e ndodhjes së situatës dhe kushtin /kushtet e vendosura, për shembull për disa lloje automjesh, të lidhura me përditësimin;

d) datën e përditësimit të të dhënave;

dh) datën dhe orën kur ka ndodhur ose është planifikuar të ndodhë ndryshimi në një situatë të caktuar;

e) cilësinë e përditësimit të të dhënave sikurse përcaktuar në kërkesat e cilësisë, të aprovuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas konsultimit paraprak me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, NAPCORE dhe autoritetet homologe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

2. Vendndodhja e situatës, për të cilën bëhet përditësimi, përcaktohet duke përdorur një metodë të standardizuar ose çdo metodë tjetër të përdorur gjerësisht dhe të pranuar përgjithësisht të referimit të vendndodhjes dinamike që mundëson dekodimin dhe interpretimin plotësisht të qartë të kësaj vendndodhjeje.

3. Mbajtësit përkatës të të dhënave përditësojnë këto të dhëna mbi rregullat dhe kufizimet, brenda një afati kohor që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të të dhënave në shërbimet e informacionit të trafikut në kohë reale dhe aty ku



dihet dhe është e mundur, ia ofrojnë paraprakisht këto përditësime përdoruesve të të dhënave.

4. Mbajtësit përkatës të të dhënave korrigjojnë në kohën e duhur çdo pasaktësi të zbuluar prej tyre në të dhënat e tyre ose të sinjalizuar tek to nga çdo përdorues i të dhënave dhe çdo përdorues fundorë i shërbimit të të dhënave.

5. Prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve të hartave digjitale që, ofrojnë informacion për përdoruesit fundorë të shërbimeve, i përpunojnë përditësimet përkatëse të të dhënave për rregullat dhe kufizimet, brenda një afati kohor të përshtatshëm për përdorimin e besueshëm dhe efektiv të të dhënave në shërbimet e informacionit të trafikut në kohë reale.

6. Informacioni i trafikut në kohë reale modifikohet në përputhje me rrethanat ose fshihet sa më shpejt që është e mundur pas ndryshimit të statusit të të dhënave në fjalë.

Neni 10

Përditësimi i të dhënave për gjendjen e rrjetit

1. Përditësimi i të dhënave për gjendjen e rrjetit përfshin të paktën parametrat e mëposhtëm:

a) llojin e të dhënave të përcaktuara në pikat 4 dhe 5, të shtojcës 1, në lidhje me përditësimin dhe, sipas rastit, një përshkrim të shkurtër të tij;

b) vendndodhjen e ngjarjes ose situatës me të cilën lidhet përditësimi;

c) periudhën e ndodhjes së ngjarjes ose situatës me të cilën lidhet përditësimi;

ç) cilësinë e përditësimit të të dhënave sikurse përcaktuar në kërkesat e cilësisë, të aprovuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar pas konsultimit paraprak me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, NAPCORE dhe autoritete homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

2. Vendndodhja e ngjarjes ose situatës për të cilën bëhet përditësimi, përcaktohet duke përdorur një metodë të standardizuar ose çdo metodë tjetër të përdorur gjerësisht dhe të pranuar përgjithësisht të referimit të vendndodhjes dinamike që mundëson dekodimin dhe interpretimin plotësisht të qartë të kësaj vendndodhjeje.

3. Mbajtësit përkatës të të dhënave përditësojnë të dhënat për gjendjen e rrjetit, brenda një afati kohor që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të të dhënave në shërbimet e informacionit të trafikut në kohë reale dhe aty ku dihet dhe është e

mundur, ua ofrojnë paraprakisht këto përditësime përdoruesve të të dhënave.

4. Mbajtësit përkatës të të dhënave korrigjojnë, në kohën e duhur, çdo pasaktësi të zbuluar prej tyre në të dhënat e tyre ose të sinjalizuar tek to nga çdo përdorues i të dhënave dhe çdo përdoruesi fundor të shërbimit të këtyre të dhënave.

5. Informacioni i trafikut në kohë reale modifikohet në përputhje me rrethanat ose fshihet sa më shpejt që është e mundur, pas ndryshimit të statusit të të dhënave në fjalë.

6. Ofruesit e shërbimeve që, ofrojnë informacion për përdoruesit fundorë të shërbimeve, i përpunojnë përditësimet përkatëse të të dhënave për gjendjen e rrjetit, brenda një afati kohor të përshtatshëm për përdorimin e besueshëm dhe efektiv të të dhënave, në shërbimet e informacionit të trafikut në kohë reale.

Neni 11

Përditësimi i të dhënave për përdorimin në kohë reale të rrjetit

1. Përditësimi i të dhënave për përdorimin në kohë reale të rrjetit përfshin të paktën parametrat e mëposhtëm:

a) llojin e të dhënave, të përcaktuara në pikën 6 të shtojcës 1, në lidhje me përditësimin dhe sipas rastit, një përshkrim të shkurtër të tij;

b) vendndodhjen e ngjarjes ose situatës me të cilën lidhet përditësimi;

c) cilësinë e përditësimit të të dhënave sikurse përcaktuar në kërkesat e cilësisë, të aprovuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas konsultimit paraprak me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

2. Vendndodhja e ngjarjes ose situatës për të cilën bëhet përditësimi, përcaktohet duke përdorur një metodë të standardizuar ose çdo metodë tjetër të përdorur gjerësisht dhe të pranuar përgjithësisht të referimit të vendndodhjes dinamike që mundëson dekodimin dhe interpretimin plotësisht të qartë të kësaj vendndodhjeje.

3. Informacioni i trafikut në kohë reale ose të dhënat përkatëse modifikohen në përputhje me rrethanat ose fshihen sa më shpejt që është e mundur pas ndryshimit të statusit të të dhënave në fjalë.



4. Ofruesit e shërbimeve që ofrojnë informacion për përdoruesit fundorë të shërbimeve, i përpunojnë përditësimet e të dhënave për përdorimin e rrjetit në kohë reale brenda një afati kohor të përshtatshëm për përdorimin e besueshëm dhe efektiv të të dhënave në shërbimet e informacionit të trafikut në kohë reale.

Neni 12

Aprovimi i kërkesave të cilësisë

1. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) aprovon pas konsultimit paraprak me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, kërkesat minimale të cilësisë dhe afatet kohore për ofrimin e të dhënave në infrastrukturë, që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të tyre për të krijuar informacion në kohë reale të trafikut, sikurse përcaktuar në nenin 4 të këtij udhëzimi.

2. ARRSH-ja aprovon pas konsultimit paraprak me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, kërkesat minimale të cilësisë dhe afatet kohore për ofrimin e të dhënave mbi rregullat dhe kufizimet, që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të tyre për të krijuar informacion në kohë reale të trafikut, sikurse përcaktuar në nenin 5 të këtij udhëzimi.

3. ARRSH-ja aprovon pas konsultimit paraprak me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, kërkesat minimale të cilësisë dhe afatet kohore për ofrimin e të dhënave mbi gjendjen e rrjetit, që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të tyre për të krijuar informacion në kohë reale të trafikut, sikurse përcaktuar në nenin 6 të këtij udhëzimi. ARRSH-ja, pas konsultimit me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri, përcakton edhe llojet e të dhënave të krijuara në automjetet dhe ato të ofruesve të shërbimeve private që vihen në dispozicion të përdoruesit të të dhënave dhe termat dhe kushtet e përcaktuara nga mbajtësi i të dhënave private.

4. ARRSH-ja aprovon pas konsultimit paraprak me palët përkatëse të interesuara në Shqipëri,

NAPCORE dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, kërkesat minimale të cilësisë dhe afatet kohore për ofrimin e të dhënave për përdorimin në kohë reale të rrjetit, që i përshtatet përdorimit të besueshëm dhe efektiv të tyre për të krijuar informacion në kohë reale të trafikut, sikurse përcaktuar në nenin 7 të këtij udhëzimi.

5. Kërkesat e cilësisë, të aprovuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, sipas pikave si më lart, publikohen në pikën e hyrjes digjitale.

Neni 13

Vlerësimi i përputhshmërisë

1. Autoriteti Rrugor Shqiptar vlerëson nëse kërkesat e përcaktuara në nenet 3 deri në 11 janë përmbushur nga mbajtësit e të dhënave dhe përdoruesit e të dhënave për të cilët zbatohen këto nene në përputhje me pikat 2 dhe 4, të këtij neni.

2. ARRSH-ja, për të kryer vlerësimin e zbatimit të detyrimeve të këtij udhëzimi, kërkon nga çdo mbajtës dhe përdorues i të dhënave, dokumentet e mëposhtme:

a) një përshkrim të të dhënave, hartës digjitale ose shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale që ai ofron, si dhe informacionin mbi cilësinë e tyre dhe kushtet e ripërdorimit të këtyre të dhënave;

b) një deklaratë të bazuar në prova për plotësimin e rregullave të përcaktuara në nenet 3 deri në 11 të këtij udhëzimi.

3. ARRSH-ja, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, miraton formatin/formatet standard të deklaratës së përmendur në germën “b”, të pikës 2, të këtij neni.

4. ARRSH-ja kontrollon në mënyrë të rastësishme korrektësinë e deklaratave të përmendura në germën “b”, të pikës 2, të këtij neni.

Neni 14

Raportimi

1. Autoriteti Rrugor Shqiptar i paraqet ministrit përgjegjës për transportin, listën dhe vizualizimin e hartave të rrugëve të përfshira në rrjetin rrugor parësorë/kryesorë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

2. Autoriteti Rrugor Shqiptar i paraqet ministrit përgjegjës për transportin, brenda datës 1 janar 2026, informacionin e mëposhtëm:



a) përparimin e bërë në drejtim të aksesueshmërisë, shkëmbimit dhe ripërdorimit të llojeve të të dhënave të përcaktuara në shtojcën 1;

b) shtrirjen gjeografike të të dhënave të aksesueshme nëpërmjet tij, ndryshimet në rrjetin rrugor primar dhe në përmbajtjen e të dhënave të shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale dhe cilësinë e tyre, duke përfshirë kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë cilësi dhe mjetet e përdorura për ta monitoruar atë;

c) rezultatet e vlerësimit të përputhshmërisë të përmendur në nenin 13 me kërkesat e përcaktuara në nenet 3 deri në 11 të këtij udhëzimi.

Neni 15

Përpunimi i të dhënave personale dhe lëvizja e lirë e tyre

Përpunimi i të dhënave personale dhe lëvizja e lirë e tyre kryhet në përputhje me Ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe për mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike, në përputhje me ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 16

Dispozitat kalimtare

1. Deri më datë 31 dhjetor 2027, detyrimet në lidhje me llojet e të dhënave sipas pikave 1, 3, 5 dhe 6 të shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, zbatohen vetëm për këto kategori rrugësh:

a) rrugët pjesë e rrjetit gjithëpërfshirës rrugor transevropian;

b) autostrada të tjera që nuk përfshihen në rrjetin rrugor gjithëpërfshirës transevropian;

c) rrugët parësore/kryesore.

2. Rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim zbatohen pas ngritjes dhe publikimit të Sistemit Inteligent të Transportit, për dhënien e shërbimit të informacionit të trafikut në kohë reale.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCA 1

(sikurse përmendet në nenet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 14 dhe 15)

1. Llojet e të dhënave për infrastrukturën:

a) lidhjet e rrjetit rrugor dhe cilësitë e tyre fizike:

i. gjeometria;

ii. gjerësia e rrugës;

iii. numri i korsive;

iv. gradientët;

v. kryqëzimet;

b) klasifikimi i rrugëve;

c) vendndodhja e stacioneve të pagesës së tarifës;

ç) vendndodhja e zonave të shërbimit dhe zonave të pushimit;

d) vendndodhja e pikave të karikimit për automjetet elektrike dhe kushtet për përdorimin e tyre;

dh) vendndodhja e pikave të gazit natyror nën presion, gazit natyror të lëngshëm, stacioneve të gazit të lëngshëm të naftës;

e) vendndodhja e pikave dhe stacioneve të karburantit për të gjitha llojet e tjera të karburanteve;

ë) vendndodhja e zonave të dorëzimit.

2. Llojet kryesore të të dhënave për rregullat dhe kufizimet:

a) rregullat statike dhe dinamike të trafikut, aty ku zbatohen:

i. kushtet e hyrjes në tunele;

ii. kushtet e aksesit në ura;

iii. kufizimet e përhershme të aksesit;

iv. kufijtë e shpejtësisë;

v. rregullat e shpërndarjes së mallrave;

vi. ndalimi i parakalimit të mjeteve të rënda të mallrave;

vii. kufizimet e peshës/gjatësisë/gjerësisë/lartësisë;

viii. rrugët me një drejtim;

ix. kufijtë e kufizimeve, ndalimeve ose detyrimeve me vlefshmëri zonale, statusi aktual i aksesit dhe kushtet për qarkullim në zonat e rregulluara të trafikut;

x. drejtimi i lëvizjes në korsitë të kthyeshme;

b) planet e qarkullimit të trafikut rrugor.

3. Llojet e tjera të të dhënave mbi rregullat dhe kufizimet:

a) vendndodhja dhe identifikimi i shenjave të trafikut që pasqyrojnë rregullat e trafikut dhe identifikojnë rreziqet:

i. kushtet e hyrjes në tunele;



ii. kushtet e aksesit në ura;

iii. kufizimet e përhershme të aksesit;

iv. shenja të tjera të trafikut që pasqyrojnë rregullat e trafikut;

b) rregullat statike dhe dinamike të trafikut, aty ku zbatohen, përveç rregullave të trafikut të përmendura në pikën 2;

c) identifikimi i rrugëve me pagesë, tarifat e aplikueshme fikse të përdoruesit dhe mënyrat e disponueshme të pagesës (duke përfshirë kanalet e shitjes me pakicë dhe metodat e përmbushjes);

ç) tarifat e ndryshueshme të përdoruesve të rrugës dhe mënyrat e disponueshme të pagesës, duke përfshirë kanalet e shitjes me pakicë dhe metodat e përmbushjes.

4. Llojet kryesore të të dhënave për gjendjen e rrjetit:

a) mbylljet e rrugëve;

b) mbylljet e korsive;

c) punimet në rrugë;

ç) masat e përkohshme të menaxhimit të trafikut.

5. Lloje të tjera të dhënash për gjendjen e rrjetit:

a) mbylljet e urave;

b) aksidentet dhe incidentet;

c) kushtet e këqija të rrugës;

ç) kushtet e motit që ndikojnë në sipërfaqen e rrugës dhe pamjen.

6. Llojet e të dhënave për përdorimin në kohë reale të rrjetit:

a) vëllimi i trafikut;

b) shpejtësia e trafikut;

c) vendndodhja dhe gjatësia e radhëve të trafikut;

ç) koha e udhëtimit;

d) koha e pritjes në vendkalimet kufitare;

dh) disponueshmëria e zonave të dorëzimit;

e) disponueshmëria e pikave dhe stacioneve të karikimit për automjetet elektrike;

ë) disponueshmëria e pikave dhe stacioneve të karburantit për llojet alternative të karburantit;

f) çmimi i karikimit/mbushjes *ad hoc*.

NJOFTIM

Nr. 1705, datë 30.1.2025

PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

“Marrëveshja e Kombeve të Bashkuara për vendosjen e rregulloreve teknike globale për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të

instalohen ose të përdoren tek automjetet me rrota”, bërë në Gjenevë, më 25 qershor 1998, hyn në fuqi më 18 nëntor 2024 për Shqipërinë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM

Nr. 281, datë 18.12.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “MET ALBANIA” SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2497/1prot., datë 17.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘MET Albania’ sh.a. për licencim në veprimtarinë e tregtimi të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “MET Albania” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2497 prot., datë 5.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimi të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka



plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gemat “a” dhe “c”, për pikën 1,3, germat “a” dhe “c”, dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria duhet të plotësojë dhe dokumentacionin në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **germa “b”:** duhet të depozitohet dëshmia e penalitetit e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë “MET Albania” sh.a.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa “b”:** shoqëria duhet të dokumentojë mbështetjen financiare të mjaftueshme, duke bërë shpërndarjen për secilën veprimtari, duke qenë se paralelisht ka aplikuar dhe për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MET Albania” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “MET Albania” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 282, datë 18.12.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “MET ALBANIA” SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2498/1 prot., datë 17.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘MET Albania’ sh.a. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “MET Albania” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2498 prot., datë 5.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a” dhe “c”; për pikën 1,3, germat “a” dhe “c”, dhe për pikën 2.4, germën “c”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria duhet të plotësojë më tej dokumentacionin në vijim:



NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë*Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **germa “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa “b”**: shoqëria duhet të dokumentojë mbështetjen financiare të mjaftueshme, duke bërë shpërndarjen për secilën veprimtari, duke qenë se paralelisht ka aplikuar dhe për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- **germa “b”**: shoqëria duhet të informojë se si ka parashikuar të sigurojë shërbimin e IT për 6 mujorin e parë të vitit 2025.

- **germa “c”**: shoqëria duhet të informojë se kur do t'i disponojë zyrat përfaqësuese të furnizuesit.

- **germa “d”**: shoqëria duhet të japë informacion mbi mënyrën e realizimit të matjes së energjisë për klientët.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MET Albania” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “MET Albania” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 283, datë 18.12.2024

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“MOUNTAIN’S GREEN ENERGY” SHPK
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38 pika 1, germa “a” 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2346/6prot., datë 17.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Mountain’s Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2346 prot., datë 5.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau Dejës, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 1 975 kW.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 248, datë 18.11.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.11.2024 dhe 20.11.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 2346/4 prot., datë 2.12.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar gjithashtu që të bëjë



me dije ERE-n në rast se nga ana e MIE-s ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratave të depozituara në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues, në lidhje me këtë shkresë MIE nuk ka kthyer përgjigjeje.

- Me shkresën nr. 2346/3 prot., datë 25.11.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës, ku është evidentuar dhe informacioni/dokumentacioni i plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

- Në vijim shoqëria me shkresën nr. 2346/5 prot., datë 5.12.2024, ka depozituar në ERE informacion plotësues për aplikimin.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k.:

- ka marrë miratimin për transferimin e të drejtës për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë fotovoltaike me kapacitet prodhues 1975 kW, në zonën Gomsiqe, Vau i Dejës, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në miratimin përfundimtar nr. 400913 prot., datë 4.10.2017 dhe kontratave të nënshkruara me MIE-n, nga shoqëria “IN FOOD” sh.p.k. tek shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., me shkresën e MIE-snr. 3222/2 prot., datë 26.7.2021;

- ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaike me adresë në Gomsiqe, Vau i Dejës, me kapacitet 1975 kW, nëpërmjet shkresës së OSSH sh.a. 7247/3 prot., datë 3.8.2024;

- ka depozituar VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në datën 7.9.2017, për personin juridik “IN FOOD” sh.p.k. për të zhvilluar projektin: “Central diellor fotovoltaike”, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau i Dejës, qarku Shkodër.

- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9112 rep., nr., 3449 kol., datë 29.12.2017, e ndryshuar, përcaktohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka plotësuar jetëgjatësinë e pritshme për 30 vjet, ka depozituar dhe garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike dhe në planin e biznesit të saj rezulton se jetëgjatësia ekonomike e centralit do të jetë 30 vjet, ndaj në këto rrethana, dhe afati i licencës do të jetë për 30 vjet.

- Referuar parashikimeve të kontratës shtesë të nënshkruar me MIE-n nr. 1537 rep., nr. 518 kol., datë 23.6.2021, ku përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 90 ditëve nga data e pajisjes me lejet e nevojshme për fillimin e punimeve të ndërtimit e të vërë në punë centralin fotovoltaike brenda 9 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve. Shoqëria ka informuar, me shkresën e datës 5.12.2024 se ka respektuar afatet e kontratës së nënshkruar me MIE-n dhe të lejes së ndërtimit (deri më 15.12.2024). Aktualisht, punimet ndodhen në një fazë të përparuar dhe parashikohet që ato të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Në këto rrethana, vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që, përpara fillimit të operimit, të dokumentojë në ERE testimin e veprës, në përputhje me përcaktimet e nenit 10, të kontratës nr. 9112 rep., nr., 3449 kol., datë 29.12.2017, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 1 975 kW, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau i Dejës, për një afat 30-vjeçar.



2. Përpara fillimit të operimit, shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në kuadër të plotësimit të pikës 2.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë “FTL” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 284, datë 18.12.2024

**MBI MIRATIMIN E METODOLOGJISË
SË PËRCAKTIMIT TË DETYRIMIT PËR
ENERGJINË E RINOVUESHME**

Në mbështetje të neneve 16, 18, pika 1, gerrat “a” dhe “dh”; si dhe nenit 19, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, pika 8, dhe nenit 16, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; dhe neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2574 prot., datë 17.12.2024 të përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme “Mbi miratimin e Metodologjisë së përcaktimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 377, datë 26.12.2023, ka vendosur fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme.

- ERE ka njoftuar të gjithë palët e interesit për të shprehur opinionet e tyre në lidhje me këtë draft – metodologji, si dhe ka publikuar dokumentin në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në seksionin “Konsultime”.

- Palët e interesit të cilët kanë paraqitur komentet e tyre janë: Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA) me shkresën nr. l810/206 prot., datë 23.2.2024; Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) me shkresën nr. l502 prot, datë 15.2.2024 dhe shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., me shkresën nr. 384/1 prot., datë 26.3.2024. Drafti i metodologjisë është diskutuar edhe me konsulentët, të cilët kanë ofruar asistencën e tyre, me qëllim adresimin e komenteve të arsyetuara të palëve të interesit.

- Në vijim, në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s, më datë 17.10.2024 u zhvillua një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ERE-s, FTL sh.a., AREA dhe OSHEE Group, ku u diskutuan dhe u adresuan komentet e paraqitura nga palët e interesit.

- Komentet e palëve të interesit janë fokusuar në afatin për paraqitjen e të dhënave, parapagimin nga furnizuesit, kalimin e marrëveshjeve të blerjes së energjisë tek OER-ja pas konsolidimit të tij, përgjegjësinë balancuese, rikuperimin e pagesave nga furnizuesit e tjerë dhe hyrjen në fuqi të metodologjisë me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme.

- Në lidhje me komentet e paraqitura nga palët e interesit, sqarojmë se ERE ka marrë parasysh pjesërisht komentet mbi afatin për paraqitjen e të dhënave dhe parapagimin nga furnizuesit, duke shtyrë afatin e dorëzimit të të dhënave nga furnizuesit dhe prodhuesit të OER-së, si dhe nga OER-ja tek ERE.

- Në lidhje me parapagimin, duke iu referuar përcaktimeve të nenit 16, pika 12, të ligjit nr. 24/2023, ERE ka parashikuar që për tre muajt e parë OER-ja të ketë të drejtën e parapagimit, ndërsa në çdo rast tjetër duhet t’i drejtohet ERE-s me një kërkesë. Gjithashtu, në metodologji është përfshirë



koncepti i garancive bankare. Sa i përket rikuperimit të pagesave nga furnizuesit e tjerë, kjo dispozitë bazohet në përcaktimet e pikës 10, të nenit 16, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Komentet mbi përgjegjësinë balancuese nuk janë reflektuar në metodologji, pasi nuk lidhen me këtë dokument. Sa i përket hyrjes në fuqi të metodologjisë, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 696, datë 13.11.2024, ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e “Operatorit të Energjisë së Rinovueshme” sh.a., si dhe nga ana e ERE-s është parashikuar një dispozitë kalimtare në nenin 10 të metodologjisë, e cila përcakton se për miratimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme për vitin 2025, OER-ja, apo çdo entitet i cili kryen detyrat e tij, do të mund të paraqesë një kërkesë në ERE jo më vonë se data 31 mars 2025, pavarësisht afatit të përcaktuar në nenin 7 të metodologjisë.

- Metodologjia është e strukturuar si vijon:

i. **pjesa e parë:** “Dispozita të përgjithshme” – përmban qëllimin e metodologjisë, bazën ligjore dhe përkufizimet;

ii. **pjesa e dytë:** “Roli dhe përgjegjësitë e palëve” – përfshin nenet 5, 6 dhe 7, ku përcaktohen roli dhe përgjegjësitë e OER-së, furnizuesve të energjisë elektrike dhe parashikimi vjetor i energjisë së prodhuar nga prodhuesit me përparësi;

iii. **pjesa e tretë** e metodologjisë: “Llogaritja e detyrimit të energjisë së rinovueshme”, përfshin metodën e llogaritjes së këtij detyrimi, duke përfshirë mbështetjen për Kpd dhe FiT, kostot e balancimit, kapitalin e punës, kostot operative dhe mirëmbajtjes, faktorin e korigjimit dhe përcaktimin e grupeve të konsumatorëve fundorë;

iv. **pjesa e katërt** e metodologjisë përcakton faturimin, pagesën dhe rregullimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme, si dhe mbështetjen për prodhuesit me përparësi. Detyrimi i energjisë së rinovueshme do të shënohet si zë i veçantë në faturën e konsumatorit, ndërsa prodhuesit me përparësi do të lëshojnë fatura ndaj OER-së, dhe pagesat do të kryhen sipas kushteve të përcaktuara. Furnizuesit janë të detyruar të paguajnë pjesën e tyre të detyrimit tek OER-ja sipas kontratës. ERE llogarit diferencat ndërmjet vlerave të parashikuara dhe të realizuara, duke rregulluar të ardhurat e tepërta ose mungesat në detyrimin e vitit pasardhës;

v. **pjesa e pestë** dhe e fundit e metodologjisë përfshin dispozitat kalimtare, rishikimin e

jashtëzakonshëm të detyrimit për energjinë e rinovueshme, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, rishikimin dhe ndryshimin e metodologjisë, si dhe hyrjen në fuqi të saj. Dispozitat kalimtare parashikojnë se për detyrimin e energjisë së rinovueshme për vitin 2025, OER-ja, ose entiteti përkatës, mund të paraqesë kërkesë në ERE, në rast të plotësimit të kushtit të përcaktuar në nenin 4.2, jo më vonë se data 31 mars 2025, pavarësisht afatit të përcaktuar në nenin 7. Ndryshimi i metodologjisë do të bëhet me vendim të Bordit të ERE-s, në përputhje me rregulloren për funksionimin e saj, ndërsa hyrja në fuqi do të realizohet pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

- Në metodologji përcaktohet se OER-ja do të veprojë si blerës i energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi të mbështetur përmes kontratave dhe tarifave nxitëse, duke mbajtur përgjegjësi kontraktore për mbulimin e pagesave. OER-ja do të lëvrojë energjinë në tregun e organizuar, në tregun bilateral ose në tregun balancues, sipas kushteve të tregut. Gjithashtu, do të jetë përgjegjës për faturimin dhe mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme nga furnizuesit, si dhe për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në ERE për llogaritjen e këtij detyrimi. Kostot e tij do të mbulohen përmes fondit të detyrimit të energjisë së rinovueshme. OER-ja do të kërkojë garanci bankare nga furnizuesit e energjisë 15 ditë para fillimit të vitit kalendarik, sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar prej tij.

- Në zbatim të nenit 5 të metodologjisë, përgjegjësitë e furnizuesve të energjisë elektrike janë: *paraqitja e parashikimit vjetor të vëllimit të energjisë që do të furnizohet tek OER-ja brenda afateve të përcaktuara, faturimi dhe mbledhja e detyrimit të energjisë së rinovueshme nga konsumatorët fundorë, si dhe aplikimi i vlerës së këtij detyrimi në lekë/kWh, bazuar në sasinë e energjisë së konsumuar nga grupi balancues i furnizuesit.* Në nenin 6 janë parashikuar procedurat dhe afatet lidhur me parashikimin vjetor të energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi, të cilët përfitojnë nga njëra prej skemave të mbështetjes.

- Metodologjia përcakton se detyrimi i energjisë së rinovueshme në lekë/kWh llogaritet duke marrë në konsideratë faktorët kryesorë: *mbështetjen për Kontratat për Diferencë (KpD), mbështetjen për tarifën nxitëse (FiT), kostot e balancimit, kapitalin e punës dhe kostot e likuiditetit, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, faktorin e korigjimit për diferencat e vitit të kaluar, si dhe*



përcaktimin e grupeve të konsumatorëve fundorë bazuar në konsumin total të energjisë elektrike për periudhën përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË DETYRIMIT PËR ENERGJINË E RINOVUESHME

PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo metodologji përcakton përlogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t'u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, mbështetur në përcaktimet e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo metodologji hartohet në mbështetje të neneve 16 dhe 30 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe nenit 19, gërma “b” e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Neni 3

Përkufizime

1. Në këtë metodologji termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri.
- “Detyrimi për energjinë e rinovueshme” është një tarifë fikse që aplikohet për klientët fundorë për të mbuluar kostot e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të konsumuar nga secili klient fundor, e llogaritur në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe këtë metodologji.
- “Operatori i Energjisë së Rinovueshme” ose “OER” është pala kontraktuese e prodhuesve me përparësi të kualifikuar për mbështetje në përputhje me ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, nëpërmjet kontratës për mbështetje, ose i mbështetur përmes sistemit të tarifave nxitëse përmes marrëveshjeve për blerjen e energjisë.
- “Kontratë për diferencë” (KpD) është një kontratë për mbështetje, e rregulluar financiarisht, ku Operatori i Energjisë së Rinovueshme i paguan prodhuesit me përparësi diferencën midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës kur çmimi i referencës është më i ulët se çmimi i garantuar dhe prodhuesi me përparësi i paguan diferencën Operatorit të Energjisë së Rinovueshme kur çmimi i referencës është më i lartë se çmimi i garantuar.



- **“Kontratë për mbështetje”** është kontratë përmes së cilës prodhuesit me përparësi i jepet mbështetje sipas ligjit nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*.
- **“Kontratë për prim”** është një kontratë për mbështetje ku paguhet një prim fiks (që mund të jetë pozitiv ose negativ në varësi të rezultatit të procesit konkurrues) ose një prim rrëshqitës (si diferencë midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës) nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme për prodhuesit me përparësi mbi çmimin e tregut.
- **“Çmim i Garantuar”** është çmimi fitues i arritur në një proces konkurrues me të cilin prodhuesi me përparësi do të shesë energjinë elektrike sipas skemës së mbështetjes ose diferenca e të cilit me çmimin referencë do të mbulohet financiarisht.

“Çmimi i referencës” është çmimi i vendosur në lidhje me tregun shqiptar të ditës në avancë që operohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sipas përcaktimeve të skemës së mbështetjes. Llogaritja e çmimit të referencës dhe rregullat për trajtimin e çmimeve negative do të përcaktohen në dokumentet për çdo proces konkurrues dhe në kontratat e mbështetjes sipas ligjit nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*. Në rast se çmimi i referencës është negativ, ai do të konsiderohet zero për qëllimin e rregullimit të KpD-së.

- **“Konvertimi KpD”** është konvertimi i një MBE në një KpD në përputhje me nenin 30 pika 5, të ligjit nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*.
- **“Marrëveshja e blerjes së energjisë (MBE)”** është një marrëveshje për mbështetje, ku OER garanton blerjen fizike të detyrueshme të energjisë elektrike të gjeneruar nga prodhuesit për një çmim fiks.
- **Furnizues** është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.
- **“Klient fundor”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.
- **“Ligji për BRE-të”** nënkupton ligjin nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*.
- **“Prodhues me përparësi”** është çdo prodhues i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë që përfiton nga një skemë mbështetëse sipas akteve ligjore në fuqi.
- **“Prodhues ekzistues me përparësi”** është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*, ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaiik deri në 2 MW, eolik deri në 3 MW dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri 15 MW.
- **“Kapitali i Punës/Kostot e likuiditetit”** ka kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.
- **“Mbështetja FiT”** ka kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.



- “Mbështetja KpD” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.
 - “Faktori i rakordimit/korrigjimit” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.
2. Termat, përkufizimet e të cilave nuk renditen në pikën 1 të këtij neni, marrin për referencë termat dhe përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

PJESA II ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE

Neni 4

Roli dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme

1. OER-ja do të jetë blerësi i energjisë elektrike i të gjithë prodhuesve me përparësi të kualifikuar për mbështetje nëpërmjet kontratës për mbështetje, ose të mbështetur përmes sistemit të tarifave nxitëse përmes marrëveshjeve për blerjen e energjisë.
2. Energjia e blerë nga OER-ja do të lëvrohet direkt në tregun e organizuar të ditës në avancë dhe/ose brenda të njëjtës ditë.
3. Për periudhën kohore që ALPEX nuk mund të prodhojë çmime, do të merret për bazë shitja e energjisë elektrike në tregun bilateral dhe/ose përfitimi potencial, nëse e aplikueshme, nga ekspozimi në tregun balancues.
4. OER-ja do të ketë përgjegjësi kontraktore ndaj çdo prodhuesi me përparësi për mbulimin e pagesave që rezultojnë nga çdo kontratë për mbështetje e lidhur ndërmjet OER dhe prodhuesit me përparësi.
5. OER-ja është përgjegjës për faturimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme tek të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike të cilët ushtrojnë aktivitetin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve fundorë.
6. OER-ja është përgjegjës për mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme nga të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike të cilët ushtrojnë aktivitetin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve fundorë dhe për pagesën e këtij detyrimi ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.
7. OER-ja ka përgjegjësinë e mbledhjes së të gjithë të dhënave nga prodhuesit me përparësi të energjisë të kualifikuar për mbështetje në lidhje me vëllimin vjetor të energjisë elektrike të prodhuar dhe/ose parashikuar për t'u prodhuar nga energjitë e rinovueshme, periudhën dhe skemën e mbështetjes, si dhe mbështetjen në lidhje me përgjegjësinë balancuese për prodhuesit me përparësi që janë plotësisht apo pjesërisht të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese.
8. Pas mbledhjes së të dhënave, OER-ja do të grumbullojë të dhënat e paraqitura nga të gjithë prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe do t'i dorëzojë në ERE për të llogaritur detyrimin e energjisë së rinovueshme, i cili do t'u ngarkohet të gjithë konsumatorëve fundorë.
9. OER-ja me qëllim garantimin e neutralitetit të saj financiar të rregulluar do të shpërndajë kostot e disbalancave të shkaktuara prej prodhuesve me përparësi në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të balancimit të energjisë elektrike dhe akteve të tjera ligjore fuqi, dhe do të mbledhë nëpërmjet detyrimit të burimeve të rinovueshme ato kosto të disbalancave të cilat janë përtej kufijve të vendosur sipas MBE respektive për ata prodhues me përparësi të cilët kanë kufi tavan lidhur me detyrimin e koston të disbalancave ose për prodhuesit të cilët janë të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese.



10. Kostot e OER do të mbulohen nëpërmjet detyrimit të energjisë së rinovueshme fondi i të cilës do të përdoret për të mbuluar kostot e skemave mbështetëse si më poshtë:
 - a) diferencat e pagueshme, nëse pozitive, ndërmjet çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e një KpD-je
 - b) pagesat e primit për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e kontratave për prim.
 - c) tarifat nxitëse për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e MBE-ve
 - d) kosto të disbalancave të cilat janë përtej kufijve të vendosur për ata prodhues me përparësi të cilët kanë kufi tavan lidhur me detyrimin e koston së disbalancave sipas MBE respektive, dhe kostot e prodhuesve që janë plotësisht të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese, nëse e aplikueshme.
 - e) kostot e përditshme operative dhe të mirëmbajtjes së OER-it, duke përfshirë, por pa u kufizuar në koston e financimit, aksesin në treg, kapitalin qarkullues dhe koston e sigurimit të rezervave për të siguruar likuiditetin financiar dhe aftësinë e pagesave të fondit të mbështetjes së energjisë së rinovueshme në baza të vazhdueshme.
 - f) Nëse OER pajiset me likuiditet nga fondet e shtetit, kostoja për shtetin shqiptar do të duhet të mbulohet nëpërmjet detyrimit të burimeve të rinovueshme.
 - g)
11. OER-ja ka të drejtën të rikuperojë çdo pagesë të paarkëtuar nga një furnizues i falimentuar, duke i ndarë këto të arkëtueshme të pambledhura me furnizuesit e mbetur në treg, në proporcion të drejtë me pjesën e tregut që zë secili furnizues.
12. OER-ja, 15 ditë përpara fillimit të çdo viti kalendarik, do të kërkojë çdo furnizuesi vënien në dispozicion të instrumentit të garancisë bankare, lëshuar nga një institucion bankar shqiptar në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga OER. Vlera e garancisë bankare do të përllogaritet duke konsideruar tarifën e furnizuesve për energjinë e rinovueshme përcaktuar nga ERE për vitin kalendarik pasardhës, shumëzuar me vëllimin mesatar të furnizuesit që i korrespondon 60 ditëve të furnizimit, shtuar dhe vlerën përkatëse të TVSH.
13. Në kuadër të parimit të rrezikut financiar zero të OER, në rast të diferencave ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve të konsumit të energjisë elektrike të çdo furnizuesi, OER do të sigurohet që çdo furnizues i energjisë elektrike të ketë lëshuar një garanci bankare, me përfitues OER, e cila në çdo interval kohor të mbulojë një ekspozim të OER të barabartë me tarifën e furnizuesve për energjinë e rinovueshme përcaktuar nga ERE për vitin kalendarik pasardhës, shumëzuar me vëllimin mesatar të furnizuesit që i korrespondon 60 ditëve të furnizimit, shtuar dhe vlerën përkatëse të TVSH. Në rast se gjatë vitit kalendarik furnizuesi do të rrisë konsumin e grupit të tij balancues përtej parashikimit, do të duhet që diferencën ta mbulojë 100% me shtimin e vlerës përkatëse të garancisë bankare. Në rast se furnizuesi nuk i vë në dispozicion OER instrumentin shtesë të garancisë bankare, në formën, mënyrën, vlerën dhe afatin kohor të përcaktuar nga OER, OER do të kërkojë Operatorit të Tregut, pezullimin e furnizuesit nga tregu i energjisë elektrike (vetëm për komponentin/licencën e furnizimit), deri në përmbushjen e plotë të kërkesave të OER. Pezullimi i furnizuesit publikohet në faqen e internetit të Operatorit të Tregut. Në rast se gjatë vitit kalendarik furnizuesi do të ulë konsumin e grupit të tij balancues përtej parashikimit kontraktor, OER do të pranojë reduktimin e vlerës së garancisë bankare, respektivisht me të njëjtën vlerë të reduktimit të ekspozimit të saj financiar.
14. Në rast se furnizuesi i energjisë elektrike nuk parashikon aktivizimin e licencës së furnizimit në vitin pasardhës, nuk ka detyrim për vënien në dispozicion të instrumentit të garancisë bankare.



15. OER do t'i kerkojë çdo furnizuesi kryerjen e parapagimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme 15 ditë përpara fillimit të funksionimit të OER me qëllim garantimin e likuiditetit fillestar të këtij të fundit. Ky parapagim do të aplikohet vetëm për tre muajt e parë të fillimit të funksionimit të OER. Vlera e parapagimit do të përllogaritet duke konsideruar detyrimin e furnizuesve për energjinë e rinovueshme përcaktuar nga ERE për vitin kalendarik pasardhës, shumëzuar me vëllimin e parashikuar nga furnizuesi për 90 ditet e para të furnizimit, shtuar dhe vlerën përkatëse të TVSH. Për çdo rast tjetër, ku OER do të kerkojë kryerjen e parapagimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme nga furnizuesit e energjisë elektrike, ai do të paraqesë një kërkesë në ERE, e cila do të shqyrtohet rast pas rasti nga ERE, duke përcaktuar dhe vlerën e këtij parapagimi, në përputhje me ligjin “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Në rast se furnizuesi nuk kryen parapagimin në vlerën dhe afatin kohor të përcaktuar, OER do ti kërkojë Operatorit të Tregut, pezullimin e furnizuesit nga tregu i energjisë elektrike (vetëm për komponentin/licencën e furnizimit), deri në përmbushjen e plotë të kërkesave të OER. Pezullimi i furnizuesit publikohet në faqen e internetit të Operatorit të Tregut.
16. Operatori i Energjisë së Rinovueshme mban të dhëna të hollësishme për të gjitha masat që përfshijnë dhënien e mbështetjes. Këto të dhëna duhet të mbahen gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për mbështetje dhe për një periudhë shtesë prej dhjetë vjetësh, duke përfshirë të gjitha informacionet e nevojshme për të provuar se kushtet e kontratës për diferencë, kontratës për prim dhe MBE janë përmbushur.
17. Operatori i Energjisë së Rinovueshme jo më vonë se 3 muaj nga aplikimi i detyrimit të burimeve të rinovueshme ndaj furnizuesve të energjisë elektrike, do të krijojë një regjistër online të prodhuesve me përparësi të kualifikuar për mbështetje dhe do ta përditësojë atë vazhdimisht me baza 3 mujore.

Neni 5

Roli dhe përgjegjësitë e furnizuesve të energjisë elektrike

1. Brenda datës 1 Tetor të çdo viti, të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike do t'i paraqesin OER një parashikim vjetor të vëllimit të energjisë elektrike që pritet të furnizohet prej tyre, të ndarë sipas muajve për vitin pasardhës si dhe energjinë elektrike të furnizuar prej tyre në vitin paraardhës, të ndarë me bazë mujore.
2. Çdo furnizues i energjisë elektrike është përgjegjës për faturimin dhe mbledhjen nga konsumatorët fundorë të detyrimit të energjisë së rinovueshme të faturuar nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme.
3. Furnizuesi faturon vlerën e detyrimit për energjinë e rinovueshme në lekë për kWh për të gjithë klientët fundorë sipas sasisë përkatëse të energjisë elektrike të konsumuar nga grupi i tij balancues.

Neni 6

Parashikimi vjetor i energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi

1. Brenda datës 1 Tetor të çdo viti, të gjithë prodhuesit me përparësi në operim si dhe prodhuesit me përparësi të cilët planifikojnë të vënë në funksion impiantet e tyre në vitin pasardhës, duhet t'i paraqesin OER një parashikim vjetor të vëllimit të energjisë elektrike



që pritet të gjenerohet nga burimet e rinovueshme, të ndarë sipas muajve për vitin pasardhës si dhe energjinë elektrike të prodhuar prej tyre në vitin paraardhës, të ndarë me bazë mujore, detyrim i cili duhet të reflektohet dhe në kontratën midis palëve.

2. Operatori i Energjisë së Rinovueshme mbledh vëllimet totale të energjisë elektrike që parashikohet të prodhohen nga burimet e rinovueshme të paraqitura nga të gjithë prodhuesit me përparësi dhe përlllogarit shumën e vlerave monetare që pritet t'u disbursohet prodhuesve me përparësi në vitin e ardhshëm. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga prodhuesit me përparësi
3. Operatori i Energjisë së Rinovueshme parashikon prodhimin total nga burimet e rinovueshme dhe kontratës për pagesën e diferencës për çdo prodhues me përparësi sipas çmimeve dhe kushteve të secilës kontratë dypalëshe si dhe legjislacionit në fuqi.

PJESA III

LLOGARITJA E DETYRIMIT TË ENERGJISË SË RINOVUESHME

Neni 7

Llogaritja e detyrimit për energjinë e rinovueshme

1. OER do të dorëzojë në ERE një kërkesë për miratimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme në përputhje me Ligjin nr. 24/2023 *‘Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme’* dhe ligjin nr. 43/2015 *‘Për sektorin e energjisë elektrike’*, i ndryshuar si dhe sipas përcaktimeve të kësaj metodologjie.
 2. Brenda datës 1 Nëntor të çdo viti, OER duhet t'i paraqesë ERE-s përlllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme të energjisë elektrike. Lidhur me të dhënat e furnizimit, OER duhet të konsiderojë vlerën më të lartë që rezulton nga krahasimi i vlerës së parashikuar nga furnizuesi dhe vlerës aktuale të vitit paraardhës. OER-ja do të marrë në konsideratë vlerat e konsumit të parashikuar për vitin pasardhës, bazuar në parashikimet më të mira të OST . Lidhur me të dhënat e prodhimit, OER duhet të konsiderojë vlerën më të lartë që rezulton nga krahasimi i vlerës së parashikuar nga prodhuesi dhe vlerës së përcaktuar në kontratën e lidhur me MIE. Në parashikimet e saj OER duhet të konsiderojë dhe netimin e energjisë elektrike të vetëprodhuesve sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.
 3. ERE, në rast të diferencës pozitive ndërmjet çmimit/njësi të kontratave të prodhuesve me përparësi dhe çmimit të pritshëm të tregut të vitit pasardhës, përfshirë dhe koston/njësi të OER, do të përcaktojë vlerën e detyrimit për energjinë e rinovueshme në lekë për kWh sipas sasisë përkatëse të energjisë elektrike konsumuar nga secili klient fundor. Ky detyrim do të përcaktohet në mënyrë që të mbulojë kostot e mëposhtme bazuar në formulën dhe hapat e paraqitura në vijim.
 4. ERE, në rast të diferencës negative ndërmjet çmimit/njësi të kontratave të prodhuesve me përparësi dhe çmimit të pritshëm të tregut të vitit pasardhës, përfshirë dhe koston/njësi të OER (çmimi i bursës ose kontratave bilaterale parashikohet që të jetë jo vetëm më i lartë se çmimi i prodhuesve me përparësi, por dhe që të mbulojë plotësisht të gjitha kostot e OER), detyrimi respektiv i furnizuesve, me bazë tremujore ose vjeçare, lidhur me energjinë e rinovueshme, do të jetë zero.
- A. **Mbështetja KpD** (Kontratë për Diferencë) nënkupton vlerën e mbështetjes që duhet t'u paguhet ose marrë prej prodhuesve me përparësi me kontrata KpD
- B. **Mbështetja FiT** nënkupton vlerën e mbështetjes që duhet t'i paguhet kontratave FiT për prodhuesit e vegjël me përparësi ose kontratave FiT për prodhuesit me përparësi të dhëna sipas procedurave konkurruese.



- C. **Kostot e balancimit** nënkupton kostot e balancimit të shkaktuara nga prodhuesit e vegjël të energjisë së rinovueshme (nëse e parashikuar në rregullat e balancimit) ose, aty ku është e aplikueshme, kostot e shkaktuara mbi kufirin e tarifës së balancimit të vendosur në MBE respektive me prodhuesit me përparësi. Në çdo rast, kostot e balancimit do të përlllogariten në përputhje me rregullat e balancimit në fuqi.
- D. **Kapitali i punës/kostot e likuiditetit** nënkuptojnë kostot e kapitalit të punës për Operatorin e Energjisë së Rinovueshme dhe kostot e rezervës/provizionit për të siguruar likuiditet në sasi të mjaftueshme dhe në vazhdimësi për të garantuar përmbushjen nga OER në kohën e duhur të të gjitha detyrimeve të KpD/MBE në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në KpD/MBE.
- E. **Kostot e përditshme operative dhe të mirëmbajtjes së OER** nënkuptojnë shpenzimet e realizuara në mënyrë të arsyshme nga OER për operacionet e saj ditore.
- F. **Faktori i rakordimit/korrigjimit** nënkupton një faktor që rregullon diferencat ndërmjet vlerave të parashikuara të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe vlerave të realizuara të fondit të vitit të kaluar.
- G. **Përcaktimi i grupeve të konsumatorëve fundorë (Q)**, përfshin të gjithë klientët fundor, të cilëve do t'u kërkohej të paguanjesh detyrimin e energjisë së rinovueshme, duke përlllogaritur totalin e konsumit të energjisë elektrike në kWh për grupet përkatëse të klienteve fundorë për periudhën respektive.

$$\text{Detyrimi i Energjisë së Rinovueshme (në Lek për kWh)} = \frac{A+B+C+D+E+F}{Q}$$

(Formula 1)

Më poshtë paraqiten hapat e llogaritjes së secilit komponent të formulës.

A. Mbështetja KpD:

- Përfshin të gjitha kontratat KpD që kanë të drejtë të marrin mbështetje përmes skemës.
- Çdo mbështetje për kontratë KpD duhet të përcaktojë:
 - i. Çmimin e garantuar (ÇG) në lekë për MWh. Nëse çmimi i garantuar në kontratë është i specifikuar në një monedhë të huaj, duhet përdorur kursi mesatar i këmbimit të asaj monedhe kundrejt lekut gjatë vitit paraardhës.
 - ii. Llogaritjen e çmimit mesatar të referencës (ÇR) së KpD në lekë/MWh që pritët për vitin tjetër, e ndarë në katër tremujorë, llogaritje e cila do të marrë në konsideratë reduktimin e riskut të mungesës së financimit. Si çmim mesatar për çdo tremujor, OER-ja do të konsiderojë çmimin mesatar të HUDEX, në profilin bandë, të secilit muaj për çdo tremujor të vitit pasardhës, minus 20%. HUDEX do të zëvendësohet me ALPEX, vetëm kur ALPEX të fillojë tregtimin e produkteve derivative me bazë tremujore, në një diapazon një vjeçar.
 - iii. Llogaritjen e sasisë së pritshme të prodhimit të energjisë elektrike (PP) për vitin pasardhës të shprehur në MWh..
 - iv. Llogaritjen e pagesës së mbështetjes për prodhuesit (nëse çmimi i garantuar ÇG > çmimi i referencës ÇR) ose pagesën ndaj OER (ÇG < ÇR), të pritshme për vitin pasardhës, të ndarë me baza mujore.



- v. Mbledhjen e pagesave të mbështetjes dhe ripagesave të pritshme gjatë vitit pasardhës, të ndarë me baza mujore.
- Mbledhja e pagesave të mbështetjes dhe ripagesave të pritshme gjatë vitit pasardhës, të ndarë me baza mujore për të gjitha kontratat KpD, do të përcaktohet si më poshtë:

$$A \text{ [në Lek]} = \sum_{\text{të gjitha kontratat KpD } (j)} \left[\sum_{\text{të gjithë muajt } (m)} (\zeta G_j - \zeta R_{j,m}) \times PP_{j,m} \right]$$

(Formula 2)

B. Mbështetja FiT:

- Identifikon të gjitha kontratat FiT që kanë të drejtë të marrin mbështetje përmes skemës.
- Për çdo mbështetje për kontratë FiT:
 - i. Identifikimi i tarifës nxitëse (TN) në Lek/MWh. Nëse tarifa nxitëse kontraktuale është specifikuar në një monedhë të huaj, duhet përdorur kursi mesatar i këmbimit të asaj monedhe kundrejt lekut gjatë vitit paraardhës.
 - ii. Llogaritja e çmimit mesatar të referencës FiT (ÇR) në Lek/MWh që pritet për vitin tjetër, e ndarë në katër tremujorë, llogaritje e cila do të marrë në konsideratë reduktimin e riskut të mungesës së financimit. Si çmim mesatar për çdo tremujor, OERja do të konsiderojë çmimin mesatar të HUDEX, në profilin bandë, të secilit muaj për çdo tremujor të vitit pasardhës, minus 20%. HUDEX do të zëvendësohet me ALPEX, vetëm kur ALPEX të fillojë tregtimin e produkteve derivative me bazë tremujore, në një diapazon një vjeçar.
 - iii. Llogaritja e sasisë së pritshme të gjeneruar të energjisë elektrike (PP) në çdo muaj të vitit të shprehur në MWh.
 - iv. Llogaritja e vlerës neto të mbështetjes (d.m.th TN – ÇR) të pritshme për çdo muaj të vitit.
 - v. Mbledhja e vlerave neto të mbështetjes së pritshme përgjatë gjithë muajve të vitit.
- Mbledhja e shumave neto që priten për të gjitha kontratat FiT.

$$B \text{ [në Lek]} = \sum_{\text{të gjitha kontratat FiT } (k)} \left[\sum_{\text{të gjithë muajt } (m)} (TN_k - \zeta R_{k,m}) \times PP_{k,m} \right]$$

(Formula 3)

C. Kostot e balancimit:

Kostot e balancimit të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi që janë plotësisht apo pjesërisht të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese do të jenë pjesë e përlllogaritjes së detyrimit të burimeve të rinovueshme. Në çdo rast, kostot e balancimit do të përlllogariten në përputhje me rregullat e balancimit në fuqi.

$$C \text{ [në Lek]} = C_1 + C_2$$



(Formula 4)

OST do të bashkëpunojë ngushtësisht me OER për vënien në dispozicion të të gjitha të dhënave lidhur me kostot e balancimit të Prodhuesve me Përparësi që shesin drejtpërdrejtë në ALPEX.

1. Për çdo kontratë, kostot e balancimit të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi që janë pjesërisht të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese, do të jenë pjesë e përlllogaritjes së detyrimit të burimeve të rinovueshme:

$$C_1 [\text{në Lek}] = \sum_{\substack{\text{të gjitha} \\ \text{kontratat tip 1(l)}}} PPT_l \times SMD_l \times \max(0, KMB_l - \text{ÇTSHB}_l)$$

(Formula 5)

- Parashikimi i prodhimit total (PPT) në MWh në vit.
- Vlerësimi i sasisë mesatare të disbalancave (SMD) të shprehur si një % e gjenerimit total.
- Llogaritja e kostove mesatare të balancimit (KMB) në lekë/MWh që pritet të përballojë Prodhuesi me Përparësi.
- Identifikimi i çmimit tavan të shërbimeve balancuese (ÇTSHB) në Lek/MWh, nëse përcaktohet në kontratë. Kjo mund të kërkojë një konvertim të monedhës nga Euro në Lekë.
- Llogaritja e kostove të tepërta të balancimit mbi kufirin që Prodhuesi me Përparësi do të kërkojë të rikuperojë nëpërmjet detyrimit të energjisë së rinovueshme.
- Shumatorja e kostove të tepërta të balancimit për ata prodhues me përparësi të cilët e kanë të përcaktuar në MBE respektive kufirin e tarifës së balancimit, për të gjitha kontratat kur këta Prodhues janë pjesërisht të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese.

2. Për çdo kontratë, kostot e balancimit të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi që janë plotësisht të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese (nëse e aplikueshme), do të jenë pjesë e përlllogaritjes së detyrimit të burimeve të rinovueshme:

$$C_2 [\text{in Lek}] = \sum_{\substack{\text{të gjitha} \\ \text{kontratat tip 2 (m)}}} PPT_m \times SMD_m \times KMB_m$$

(Formula 6)

- Parashikimi i prodhimit total (PPT) në MWh në vit.
- Vlerësimi i sasisë mesatare të disbalancave (SMD) të shprehur si një % e gjenerimit total.
- Llogaritja e kostove mesatare të balancimit (KMB) në lekë/MWh që pritet të përballojë Prodhuesi me Përparësi plotësisht i përjashtuar nga përgjegjësia balancuese. Shumatorja e kostove të balancimit për ata prodhues me përparësi të cilët e kanë të përcaktuar në MBE respektive se janë të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese, për të gjitha kontratat kur këta Prodhues janë plotësisht të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese.

D. Kostot e kapitalit të punës



Në varësi të masës (ose kombinimit të masave) të miratuara, duhet të përcaktohen kostot shoqëruese që mund të mbulohen përmes detyrimit të energjisë së rinovueshme.

$$D \text{ [në Lek]} = D_1 + D_2 + D_3$$

(Formula 7)

1. Për tre muajt e parë të fillimit të funksionimit, OER-ja do t'i kërkojë çdo furnizuesi kryerjen e parapagimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme. Vlera e parapagimit do të përlllogaritet si më poshtë vijon.

$$D_1 \text{ [në Lek]} = (A + B + C + D + E + F) \times \frac{n_1}{12} \times K_1$$

(Formula 8)

Ku:

- **(A+B+C+D+E+F)** është vlera e parashikuar (në Lekë) e detyrimit të energjisë së rinovueshme që furnizuesit duhet të paguajnë gjatë një viti të plotë. Formula përjashton komponentin D1 në përlllogaritjen e komponentit D.
- **n1** është numri i muajve që furnizuesit duhet të paguajnë në avancë detyrimin e energjisë së rinovueshme, specifikisht 3.
- **K1** është kostoja e shprehur (në % vjetore) e sigurimit të një kredi tremujore. Norma e interesit do të jetë fikse për të gjithë furnizuesit dhe do të përlllogaritet bazuar në normën e interesit të Bankës së Shqipërisë për kreditë tremujore.

2. Nëse OER-it i kërkohet të lëshojë një garanci bankare në përputhje me termat dhe kushtet e MBE të lidhura me Prodhuesit me Përparësi, OER do të duhet të rikuperojë kostot e garancisë bankare.

$$D_2 \text{ [në Lek]} = (A + B + C) \times \frac{n_2}{12} \times K_2$$

(Formula 9)

Ku:

- **(A + B + C)** është vlera e përlllogaritur (në lekë) e pagesave të pritshme për prodhuesit me përparësi përgjatë një viti të plotë. Për mbështetjen FiT (B), supozohet shuma neto.
- **n2** është numri i muajve të pagesave të pritshme që duhet të mbulojë garancia bankare.
- **K2** është kostoja (vjetore e shprehur në %) për OER për të mbajtur një garanci bankare gjatë një viti të plotë.

3. Nëse OER pajiset me likuiditet paraprakisht nga fondet e shtetit, kostoja për shtetin shqiptar do të duhet të mbulohet. Formula e mëposhtme supozon se tarifohet vetëm interesi.

$$D_3 \text{ [në Lek]} = KPP \times K_3$$

(Formula 10)

Ku:

- **KPP** është kapitali paraprak i punës (në lekë) i garantuar nga shteti shqiptar.
- **K3** është kostoja e kapitalit (në % (vjetore) e shtetit shqiptar.



E. Kostot operative mujore të OER-it

Kostot e renditura nën këtë zë mbulohen nga detyrimi i energjisë së rinovueshme. Në këto kosto përfshihen:

- Qiraja;
- Shpenzimet e personelit;
- Kostot e IT dhe komunikimit;
- Kostot e shërbimeve;
- Kostot e shërbimeve profesionale (ligjore, kontabiliteti, etj.);
- Kosto të tjera që lidhen me ofrimin e shërbimeve të OER.

F. Faktori i rakordimit/korrigjimit

Llogaritja e rakordimit/korrigjimit për periudhën T:

- i. Marrja në konsideratë e parashikimit të rritjes së detyrimit të energjisë së rinovueshme, shprehur në lekë, për vitin T-1 (DER (parashikim)T-1) sipas llogaritjes në vitin T-2).
- ii. Identifikimi i rritjes faktike të detyrimit të energjisë së rinovueshme, shprehur në lekë, në vitin T-1 (DER (aktual) T-1).
- iii. Marrja në konsideratë e parashikimit të vendosur në skemën mbështetëse, shprehur në lekë në vitin T-1, sipas përlllogaritjes në vitin T-2.
- iv. Identifikoni i shpenzimit faktik të skemës mbështetëse, shprehur në lekë në vitin T-1.
- v. Llogaritja e diferencës midis parashikimit dhe realizimit.
- vi. Përdorimi i faktorit të rakordimit/korrigjimit në formulën e detyrimit të energjisë së rinovueshme të aplikuar për vitin T+1.

$$F_{T+1} [\text{në Lek}] = DER(\text{parashikim})_{T-1} - DER(\text{aktuale})_{T-1} + (A + B + C + D + E)(\text{aktuale})_{T-1} - (A + B + C + D + E)(\text{parashikim})_{T-1}$$

(Formula 11)

Q. Mbulimi nga konsumatorët fundorë dhe furnizuesit

1. Përcaktimi i grupeve të konsumatorëve fundorë (Q), përfshirë të gjithë klientët familjarë dhe jo-familjarë, të cilëve do t'u kërkohet të paguajnë detyrimin e energjisë së rinovueshme.
2. Konsumi do të përlllogaritet bazuar në të dhënat e planit 10 vjeçar të OST (në mungesë të tij, në parashikimin zyrtar të dërguar nga OST për këtë qëllim).

$$Q [\text{në kWh}] = KTE$$

(Formula 12)

3. Në fund të çdo periudhe ushtrimore, ERE do të nxjerrë një vendim për vlerën e detyrimit të energjisë së rinovueshme të shprehur në Lekë për kWh që duhet paguar nga çdo konsumator fundor i energjisë elektrike (gjatë periudhës pasardhëse të likuidimit).
4. ERE do të komunikojë vendimin në mënyrë transparente të gjithëve furnizuesve të energjisë elektrike dhe klientëve fundorë dhe do ta publikojë atë në faqen e saj zyrtare si dhe në shtypin e shkruar kombëtar për 3 (tre) ditë rresht.



PJESA IV
FATURIMI DHE PAGESA E DETYRIMIT PËR ENERGJINË E
RINOVUESHME

Neni 8

**Faturimi dhe pagesa e detyrimit për energjinë e rinovueshme
dhe mbështetjen për prodhuesit me përparësi**

1. Çdo faturë e energjisë elektrike, në rast të vlerave pozitive të detyrimit të energjisë së rinovueshme, e faturuar nga furnizuesi i energjisë elektrike për një konsumator fundor, do të përfshijë detyrimin e energjisë së rinovueshme të faturuar shprehimisht si zë më vete nga furnizuesi i tyre i energjisë elektrike.
2. Çdo prodhues me përparësi do të faturojë Operatorin e Energjisë së Rinovueshme me shumat e detyrimeve në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në MBE/KpD.
3. Çdo furnizues duhet të paguajë pjesën e tij të detyrimit të energjisë së rinovueshme tek OER. OER do të llogarisë pjesën e secilit furnizues për detyrimin e energjisë së rinovueshme në raport me pjesën e parashikuar të tregut të secilit furnizues. Në varësi të periudhës së përlllogaritjes së detyrimit të burimeve të rinovueshme nga OER për kryerjen e pagesave ndaj prodhuesve me përparësi, do të përcaktohet dhe periudha e detyrimit të burimeve të rinovueshme nga furnizuesit e energjisë elektrike.
4. Faturat do të bazohen në vlerat aktuale të konsumit të energjisë elektrike të grupit balancues të çdo furnizuesi. Vlerat aktuale të konsumit do t'i vihen në dispozicion OER nga operatorët e rrjeteve, përkatësisht OST dhe OSSH, brenda tre ditëve nga data e fundit e muajit të lëvrimit. Pagesa e faturave të lëshuara nga OER do të bëhet nga furnizuesit e energjisë elektrike në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi..
5. Pagesa e faturave të lëshuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe të marra nga OER do të bëhet në përputhje me termat dhe kushtet e KpD/MBE-ve përkatëse.
6. Kushtet dhe procedurat për llogaritjen dhe mbledhjen e detyrimit për energjinë e rinovueshme do të miratohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

Neni 9

Rregullimet e detyrimit të energjisë së rinovueshme

1. ERE do të llogarisë diferencat midis vlerave dhe sasive të parashikuara dhe të realizuara për promovimin e energjisë nga burimet e rinovueshme gjatë periudhës kalendarike të mëparshme duke integruar një faktor rakordimi/korrigjimi (F) në përputhje me nenin 7 të kësaj metodologjie.
2. Rezultatet do të publikohen për të gjitha palët e interesuara dhe do të përfshihen në rishikimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme në periudhën e ardhshme rregullatore.
3. Të ardhurat e tepërta të OER do të transferohen në vitin pasardhës, ndërsa, të ardhurat e munguara do t'i shtohen detyrimit të energjisë së rinovueshme të vitit pasardhës.



PJESA V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10 Dispozitë kalimtare

Përfundimisht, për miratimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme për vitin 2025, OER apo çdo entitet i cili kryen detyrat e tij, do të mund të paraqesë një kërkesë në ERE, në rast të plotësimit të kushtit të përcaktuar në nenin 4.2, jo më vonë se data 31 mars 2025, pavarësisht afatit të përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.

Neni 11 Rishikim i jashtëzakonshëm i detyrimit për energjinë e Rinovueshme

ERE, në rast se identifikon që gjatë një viti kalendarik, komponentët e përdorur për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme ndryshojnë në masën që OER nuk mundet të shlyejë kostot e evidentuara në nenin 7 të kësaj metodologjie, mund të kryejë një rishikim brenda periudhës rregullore të detyrimit për energjinë e rinovueshme. Në rast se ERE ndryshon vlerën fikse të detyrimit, ndryshimi do të publikohet për të gjitha palët e interesuara dhe do të reflektohet në faturën e energjisë elektrike, kontratat e lidhur ndërmjet palëve si dhe në vlerën e kolateralit të lëshuar nga furnizuesi, si në rritje të vlerës ose në ulje të saj.

Neni 12 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Në rast mosmarrëveshjeje për shumat e detyrimeve, palët fillimisht do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur konfliktin me mirëkuptim të ndërsjellë.
2. Nëse nuk gjendet zgjidhje për një mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve, ERE do të veprojë si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Nëse sërish nuk gjendet një zgjidhje, palët do t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 13 Rishikimi dhe ndryshimi i metodologjisë

Kjo metodologji është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të bordit të ERE, në përputhje me “Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



VENDIM

Nr. 285, datë 18.12.2024

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
SË FILLUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË ERE-s ME NR. 79, DATË 2.5.2024,
“MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FTL
SHA PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË
DRAGOBIA ENERGY SHPK”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 20, geramat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 23 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; neneve 11 dhe 12, të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016 dhe “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 2546 prot., datë 13.12.2024, “Mbi përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 79, datë 2.5.2024 Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë Dragobia Energy sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 79, datë 2.5.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. vendosi:

1. *Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të*

gazit natyror” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

- ERE, në vijim me shkresën nr. 371/27 prot., datë 7.5.2024, ka njoftuar palët për këtë vendimmarrje dhe me shkresën nr. 1455 prot., datë 3.6.2024, me lëndë “Kërkesë për vënie në dispozicion dokumentacioni” i ka kërkuar shoqërive FTL sh.a., OST sh.a. dhe “Dragobia Energi” sh.p.k. që të depozitojnë në ERE çdo dokumentacion që vlerësojnë të nevojshëm për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje.

- ERE organizoi disa seanca dëgjimore për të zgjidhur mosmarrëveshjen ndërmjet FTL sh.a. dhe “Dragobia Energy” sh.p.k., mbi pretendimet e FTL-së për vonesën në dorëzimin e planit të prodhimit për vitin 2024. Në seancën e **21.6.2024**, ERE njoftoi palët për trajtimin e çështjes. FTL sh.a., përmes shkresës nr. **3595/12 prot., datë 11.6.2024**, theksoi qëndrimin e saj të mëparshëm, duke e konsideruar vonesën shkelje të nenit 5 të kontratës. Në seancën e datës **11.7.2024**, u kërkuar që shoqëria “**Dragobia Energy**” sh.p.k. të paraqiste prova mbi dërgimin e planit brenda afatit kontraktor. Gjatë seancës së datës **15.7.2024**, shoqëria pranoi se plani ishte dorëzuar jashtë afatit më datë **11.12.2023**, por argumentoi se kjo vonesë nuk kishte ndikuar në realizimin e detyrimeve. Shoqëria deklaroi se duke filluar nga data **25.6.2024**, kishte lëvruar të gjithë prodhimin e hidrocentralit drejt FTL-së dhe angazhohej ta bënte këtë deri në fund të vitit 2024.

- ERE, me shkresën nr. 371/34 prot., datë 30.7.2024 i është drejtuar Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike-Alpex sh.a. dhe me shkresën nr. 371/33 prot., datë 30.7.2024 i është drejtuar shoqërisë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. me të njëjtën kërkesë, duke i kërkuar informacion nëse shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. ka tregtuar energji elektrike në tregun e një dite më parë për periudhën duke filluar në datën 15 korrik 2024 e në vijim. Ndërsa me shkresën nr. 371/36 prot., datë 1.8.2024 i është drejtuar Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a. duke i kërkuar informacion nëse shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. ka tregtuar të gjithë sasinë e energjisë elektrike në FTL sh.a., duke filluar nga data 15 korrik 2024 e në vijim.

- Shoqëria Alpex sh.a. me shkresën nr. 268/1 prot., datë 31.7.2024 i ka kthyer përgjigje shkresës së ERE-s me nr. 371/4 prot, datë 30.7.2024 se shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. nuk ka tregtuar



energji në tregun e ditës në avancë të ALPEX sh.a. nga data 15.7.2024 deri më datën 31.7.2024.

- OST sh.a. me shkresën nr. 2096/8 prot., datë 2.8.2024 i ka kthyer përgjigje shkresës së ERE-s me nr. 371/4 prot., datë 30.7.2024 se shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. ka bërë nominime në platformën e OST sh.a., për kontrata bilaterale për periudhën 15 Korrik - 31 Korrik.

FTL sh.a. me shkresën nr. 3595/20 prot., datë 8.8.2024 i ka kthyer përgjigje shkresës së ERE-s me nr. 371/4 prot., datë 30.7.2024 për sasinë orare/ditore të energjisë elektrike të nominuar midis shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k.

- Me shkresën nr. **107/18 prot., datë 19.7.2024**, shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. kërkoi përfundimin e procedurës, duke argumentuar se objekti i mosmarrëveshjes ka rënë, pasi detyrimet janë përmbushur plotësisht dhe fakti mund të vërtetohet nga OST sh.a. dhe ALPEX sh.a.

- Lidhur me sa dokumentuar nga palët, nga shoqëria FTL sh.a. dhe shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., vlerësohet se energjia e nominuar për periudhën 15 korrik -31 korrik 2024 nga shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. për FTL sh.a. përkon e njëjtë me energjinë e nominuar në Platformën e OST sh.a.

- Në vijim, ERE me shkresën nr. 371/40 prot., datë 17.10.2024, i është drejtuar FTL sh.a., duke kërkuar që kjo e fundit të dorëzonte qëndrimin e saj përfundimtar mbi mosmarrëveshjen. FTL sh.a., me shkresën nr. 3595/22 prot., datë 6.11.2024, e protokolluar në ERE me nr. 371/41 prot., datë 6.11.2024, ka kthyer përgjigje, duke deklaruar se mban të njëjtin qëndrim siç është parashtruar në dokumentacionin e dorëzuar më parë, përkatësisht në shkresën nr. 3595/17 prot., datë 15.7.2024.

- Në përfundim të shqyrtimit të procedurës së hapur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 79, datë 2.5.2024, mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k., dhe duke marrë në konsideratë gjithë dokumentacionin dhe provat e dorëzuara, seancat dëgjimore të zhvilluara, përgjigjet nga OST sh.a., ALPEX sh.a., si dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në kontratën përkatëse, vlerësojmë përfundimin e procedurës për shkak se objekti i saj ka rënë. Në mbështetje të nenit 90, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”: “Procedura administrative, e nisur me

kërkesë, përfundon me një vendimarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 79, datë 2.5.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k.”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë FTL sh.a. dhe “Dragobia Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 13, datë 16.1.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të



miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 116 prot., datë 14.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2442 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 100 *mw*, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 270, datë 10.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 11.12.2024 dhe 12.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.1.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2442/4 prot., datë 13.12.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke kërkuar gjithashtu që të shprehet nëse ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së paraqitur në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Deri në këtë vendimmarrje, nga MIE nuk ka pasur asnjë përgjigje.

- Me shkresën nr. 2442/3 prot., datë 13.12.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/ dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën nr. 2442/5 prot., datë 24.12.2024.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe

afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezultoi se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1, gerrat “a”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezultoi se shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k.:

- Ka depozituar vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 673, datë 30.10.2024, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë fotovoltaiik dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesionit, në zonën kadastrale 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, qarku Fier, nga shoqëria ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k.”;

- Ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaiike, me kapacitet prodhues 100 *mw*, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Sunny Side Energy”;

- Ka depozituar shkresën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nr. 2152/3 prot., datë 26.4.2023, me anë të së cilës është miratuar në parim lidhja e Parkut Fotovoltaiik “Sunny Side Solar”, me rrjetin e transmetimit.

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 21.3.2024 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit fotovoltaiik ‘Sunny Side Solar Park’”, me fuqi 100 *mw*. Kjo VNM është e vlefshme deri më 21.3.2026.

- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, specifikohet se kontrata lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, lëshon një licencë



për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Në kushtet që shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k., sipas shkresës së OST sh.a., nr. 2152/3 prot., datë 26.4.2023, i është miratuar në parim lidhja e Parkut Fotovoltaike “Sunny Side Solar”, vlerësohet që t’i lihet kusht që të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të kontratës nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të pajiset me lejet përkatëse, të ndërtojë dhe vendosë në operim centralin brenda datës 30.10.2027, ndaj vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë që të fillojë operimin e centralit dhe ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda këtij afati.

- Rezulton se shoqëria ka një VNM të vlefshme (deri më 21.3.2026), ndaj vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes, shoqëria të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ERE në lidhje me fillimin e punimeve brenda këtij afati.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhues 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria duhet të depozitojë në ERE, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.

3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.10.2027.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të plotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k.,

Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 14, datë 16.1.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SAMASOL” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13, dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 115 prot., datë 14.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Samasol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Samasol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1854 prot., datë 2.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në



veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 185, datë 12.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.9.2024 dhe 14.9.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.9.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1927 prot., datë 16.9.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, ku me shkresën nr. 1854/3 prot., datë 30.9.2024, ERE e ka njoftuar atë për vendimin nr. 185/2024 dhe ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar në lidhje me këtë aplikim, shoqëria ka dorëzuar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1854/5 prot., datë 11.10.2024. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, është konstatuar se ende mungon një pjesë e informacionit/dokumentacionit të nevojshëm. Për këtë arsye, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 217, datë 16.10.2024, u vendos zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, rezulton se ajo ka depozituar dokumentacion plotësues për aplikimin me shkresat e protokolluar në ERE me nr. 1854/10 prot., datë 11.11.2024 dhe nr. 1855/12 prot., datë 13.11.2024.

- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit të fundit të dorëzuar dhe/ose zhvillimin e një korrespondence të mundshme me shoqërinë, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 243, datë 14.11.2024, u vendos zgjatja deri jo më vonë se data 27.1.2025 e afatit të vendimmarrjes së Bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Samasol” sh.p.k.

- ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 1854/14 prot., datë 27.11.2024, duke e njoftuar për vendimin e marrë nga Bordi i ERE-s dhe duke i kujtuar se, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezulton se një pjesë e tij ende duhet

plotësuar. Në vijim, me shkresën nr. 1854/15 prot., datë 10.12.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Samasol” sh.p.k.:

- ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 10517 rep., nr. 4879 kol., datë 28.12.2023;

- ka marrë miratimin për lidhjen e centralit fotovoltai me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nr. 7252/3 prot., datë 10.10.2022:

- është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 6.12.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltai me fuqi 2 mw, nga shoqëria “Samasol” sh.p.k.

- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 10517 rep., nr. 4879 kol., datë 28.12.2023, specifikohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, të kontratës nr. 10517 rep., nr. 4879 kol., datë 28.12.2023, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të fillojë punimet brenda 90 ditëve nga pajisja me të gjitha lejet (me të cilat nuk është pajisur akoma) dhe se do të vendosë në punë centralin brenda 12 muajve nga pajisja me këto leje. Në këto



rrethana vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të kësaj kontrate.

- Rezulton se shoqëria ka një VNM të vlefshme deri më datë 6.12.2026, ndaj vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes shoqëria të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ERE, në lidhje me fillimin e punimeve brenda këtij afati.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Samasol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara nga kontrata me MIE-n.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Samasol” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “FTL” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 15, datë 16.1.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “REBESOL” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13, dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 117 prot., datë 14.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Rebesol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Rebesol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855 prot., datë 2.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, datë 12.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.9.2024 dhe 14.9.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.9.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1927 prot., datë 16.9.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, me shkresën nr. 1855/3 prot., datë



30.9.2024, ERE e ka njoftuar për vendimin nr. 184/2024 dhe i ka evidentuar informacionin/ dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi. Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/5 prot., datë 11.10.2024, nga analizimi i së cilës ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 218, datë 16.10.2024, është vendosur zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Me shkresën me nr. 1855/7 prot., datë 24.10.2024, dhe nëpërmjet *email*-it rikujtesë protokolluar me nr. 1855/8 prot., datë 1.11.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimmarrjen e Bordit për zgjatjen e afatit dhe për sa mbetet ende pa plotësuar.

- Ndërsa, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/8 prot., datë 11.11.2024, dhe shkresën nr. 1855/9 prot., datë 11.11.2024, shoqëria ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, ndaj ERE, nëpërmjet *email*-it protokolluar me nr. 1855/10 prot., datë 12.11.2024, i ka sjellë në vëmendje dokumentacionin e rezultuar ende të paplotësuar të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka depozituar informacion / dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/11 prot., datë 13.11.2024, e me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni dhe/ose zhvillimin e një korrespondence të mundshme me shoqërinë, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 14.11.2024, u vendos zgjatja deri jo më vonë se data 26.1.2025 i afatit të vendimmarrjes së Bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Rebesol” sh.p.k.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1855/13 prot., datë 27.11.2024, me anë të së cilës i bëri me dije vendimin e marrë nga Bordi i ERE-s dhe i solli në vëmendje informacionin/ dokumentacionin që mbetet ende pa plotësuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/14 prot., datë 10.12.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues, i cili gjendet në pjesët takuese të këtij relacioni.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas

përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Rebesol” sh.p.k.:

- ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 10516 rep., nr. 4878 kol., datë 28.12.2023;

- ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., marrëveshjen e lidhjes së re nr. 9505/2 prot., datë 13.10.2023, për lidhjen e centralit fotovoltaiik me rrjetin e shpërndarjes;

- është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 3.12.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaiik me fuqi 2 mw, nga shoqëria “Rebesol” sh.p.k.

- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 10516 rep., nr. 4878 kol., datë 28.12.2023, specifikohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaiike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, të kontratës nr. 10516 rep., nr. 4878 kol., datë 28.12.2023, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të fillojë punimet brenda 90 ditëve nga pajisja me të gjitha lejet (me të cilat nuk është pajisur akoma) dhe se do të vendosë në punë centralin brenda 12 muajve nga pajisja me këto leje. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të kësaj kontrate.

- Rezulton se shoqëria ka një VNM të vlefshme, deri më datë 3.12.2026, ndaj vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes shoqëria të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ERE, në lidhje me fillimin e punimeve brenda këtij afati.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Rebesol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara nga kontrata me MIE-n.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Rebesol” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “FTL” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 16, datë 16.1.2025

**MBI PËRLLOGARITJEN E
MBËSHKETJES FINANCIARE QË
DUHET TË DOKUMENTOJNË NË ERE
SUBJEKTET QË APLIKOJNË PËR T'U
PAJISUR ME LICENCË PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
TREGTIMIT DHE/OSE FURNIZIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të

Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 152 prot., datë 15.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi përllogaritjen e mbështetjes financiare, që duhet të dokumentojnë në ERE subjektet që aplikojnë për t'u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, ka miratuar “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me vendimin nr. 215/2019 dhe me vendimin nr. 220/2022.

- Në referencë të përcaktimeve të rregullores, aplikuesit që kërkojnë të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike, në kuadër të dokumentimit të aftësisë financiare për ushtrimin e secilës prej këtyre veprimtarive, duhet të plotësojnë, ndër të tjera, dhe kërkesat e nenit 9, pika 1,3, germa “b”, të kësaj rregulloreje, duke depozituar dhe sa vijon:

Bilancin financiar i 3 (tri) viteve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazë), i audituar (kur kjo kërket nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion. (Në rastin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi).

- Për sa më sipër dhe me qëllim orientimin e drejtë të aplikuesve mbi referencat që duhet të merren për bazë në këtë përllogaritje, e cila do të bëhet duke u bazuar në të dhënat e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX sh.a., vlerësohet që neni 9, pika 1.3, germa “b”, i Rregullores të plotësohet më tej si vijon: Në rastin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi dhe përllogaritjes që do të bëhet duke marrë për bazë çmimin mujor të ditës në avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, që i korrespondon muajit që i paraprin datës së aplikimit.



- Ky përcaktim do të zbatohet për të gjitha aplikimet që do të paraqiten në ERE për licencim në veprimtarinë e tregtimit dhe atë të furnizimit të energjisë elektrike nga data 1 shkurt 2025.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE ka kompetencën dhe të drejtën për të miratuar informacionet përkatëse që duhet të paraqiten bashkëlidhur çdo aplikimi për licencë, ashtu sikurse aplikuesit kanë detyrën të depozitojnë në ERE çdo dokument apo informacion që vlerësohet i nevojshëm në kuadër të pajisjes me licencën përkatëse.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Subjektet që aplikojnë në ERE për t'u pajisur me licencë për veprimtarinë e tregtimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike duhet të bëjnë përllogaritjet për mbështetjen financiare që i nevojitet për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 muaji të veprimtarisë duke u bazuar në çmimin mujor të ditës në avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, që i korrespondon muajit që i paraprin datës së aplikimit.

2. Ky përcaktim do të zbatohet për të gjitha aplikimet që do të paraqiten në ERE për licencim në veprimtarinë e tregtimit dhe të furnizimit të energjisë elektrike nga data 1 shkurt 2025.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas Botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 17, datë 16.1.2025

MBI DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NË MUAJIN TETOR 2024 NGA PARKU FOTOVOLTAIK “BLUE 1” I SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 7 dhe 11, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, i ndryshuar; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, i ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 144 prot., datë 15.1.2025, të Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të Energjisë “Mbi dhënie e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar në muajin tetor 2024 nga parku fotovoltaik ‘Blue 1’ i shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën nr. SB1_2024_216 prot., datë 11.12.2024, protokolluar në ERE me nr. 2526 prot., datë 11.12.2024, ka paraqitur kërkesën për pajisjen me garancinë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik “Blue 1” për muajin tetor 2024.

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. është pajisur me certifikatë të garancisë së origjinës për sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik “Blue 1” në muajt qershor 2024, korrik 2024 dhe gusht 2024 respektivisht me vendimet e



Bordit të ERE-s nr. 158, datë 31.7.2024, nr. 189, datë 12.9.2024 dhe nr. 236, datë 5.11.2024.

- Referuar nenit 14.2 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për certifikatë garancie origjine do të depozitojë për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

- Shoqëria ka bërë me dije se dokumentacioni fillestar i depozituar në ERE për pajisjen me certifikatën e garancisë së origjinës nuk ka ndryshuar.

- Në vijim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., mbështetur në përcaktimet e pikës 6, të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE, me shkresën nr. 2589 prot., datë 20.12.2024, i është drejtuar operatorit të sistemit të transmetimit “OST” sh.a., me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant, për periudhën 1.10.2024–31.10.2024.

- OST sh.a., me shkresën nr. 8239/2 prot., datë 30.12.2024, protokolluar në ERE me nr. 4 prot., datë 6.1.2025, ka bërë me dije se sasia e energjisë së prodhuar bruto për periudhën 1.10.2024–31.10.2024 është 8,476.16 MWh.

- Për sa më sipër, konstatojmë se të dhënat e ardhura nga OST sh.a., janë të njëjta me ato të paraqitura nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. dhe sasia prej 8,476.16 MWh do të merret në konsideratë për lëshimin e garancisë së origjinës, në zbatim të përcaktimeve të pikave 11.2 dhe 11.3 të rregullores, ku parashikohet se garancia e origjinës lëshohet për një njësi të energjisë elektrike 1 MWh.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 22, pikës 5, të ligjit nr. 24/2023, *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltai “Blue 1”, i shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., për periudhën 1–31 tetor 2024, për sasinë 8,476 MWh.

2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

3. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të Energjisë të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 18, datë 16.1.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SHPK PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s, NR. 241, DATË 15.11.2024

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 33, pika 1, germa “a”, 144 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe neneve 15 dhe 16 pika 1 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore, me nr. 121 prot., datë 14.1.2025 “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GEN-I Tirana’ sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 241, datë 15.11.2024”.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 241, datë 15.11.2023, në pikën 1 të dispozitivit ka vendosur: 1. Detyrimin e publikimit të ofertave të furnizimit me energji



elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë në Platformën e krahimit të çmimeve të krijuar nga ERE (PCT).

- Shoqëria “GEN-I Tërana” sh.p.k. nëpërmjet shkresës me nr. 2052/8 prot., datë 10.12.2024, ka paraqitur në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 241, datë 15.11.2024 të Bordit të ERE-s, në bazë të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

- Shoqëria argumenton se propozimi i saj ka për qëllim të diferencojë furnizuesit aktivë nga ata që nuk janë angazhuar në treg, për të parandaluar informacionin mashtrues dhe konfuzionin midis konsumatorëve.

- Sa i përket afateve të parashtrimit të një kërkesë për rishikim të vendimit të ERE rezulton se, kërkesa e shoqërisë “GEN-I Tërana” sh.p.k është depozituar brenda afatit 7 ditor të parashikuar në legjislacionin në fuqi të sipërcituar.

- Vendimi i Bordit të ERE-s me nr. 241, datë 15.11.2024 i adresohet të licencuarve në aktivitetin e furnizimit. Si subjekt i licencuar nga ERE, shoqëria “GEN-I Tërana” sh.p.k. ka interes real e vetjak në këtë vendimarrje, ndaj dhe legjitimohet si palë e interesit për të ushtruar kërkesën për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s.

- Me qëllim marrjen e vlerësimit të të gjithë furnizuesve në treg të lirë, ERE gjatë seancës dëgjimore të organizuar në datë 19.12.2024, diskutoi mes të tjerave edhe në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GEN-I Tërana” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2024.

- Gjatë seancës dëgjimore iu la detyrë shoqërisë “GEN-I Tërana” sh.p.k. për saktësimin e objektit të kërkesës, sa i përket rishikimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2024, “Mbi vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë”.

- Nëpërmjet e-mailit të datës 26.12.2024, shoqëria “GEN-I Tërana” sh.p.k. ka përcjellë kërkesën e saktësuar, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2024, duke e mbështetur në nenin 14 të direktivës (EU) 2019/944, për themelimin e PCT. Në këtë kërkesë shoqëria propozon ndryshimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2024, si më poshtë:

1. Vendos detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike për familjet dhe mikrondërmarrjet me një konsum vjetor të pritshëm më pak se 100,000 kWh nga të licencuarit, të cilët janë të angazhuar aktivisht në veprimtarinë e furnizimit në tregun e lirë në Platformën e Krahimit të Çmimeve të krijuar nga ERE (PCT).

2. Subjekti i përmendur në pikën 1 është i detyruar të publikojë ofertat e furnizimit dhe të vendosë periudha vlefshmërie për çdo ofertë të publikuar.

- Për shqyrtimin e drejtë të kërkesës së shoqërisë për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 14.11.2024, duhet të kalohet në një proces konsultimi të gjerë me palët e interesit për të garantuar mbrojtjen efektive të interesave të konsumatorëve dhe funksionimin e drejtë të tregut. Kjo qasje do të mundësojë mbledhjen e mendimeve nga të gjitha palët e interesit, përfshirë furnizuesit, konsumatorët, ekspertët dhe organizatat e pavarura e veçanërisht ato me fokus mbrojtjen e konsumatorit, duke siguruar një analizë gjithëpërfshirëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “GEN-I Tërana” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 241, datë 15.11.2024.

2. Fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e ndryshimit të pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 15.11.2024, si më poshtë vijon:

- pika 1 propozohet të bëhet: *Vendos detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike për familjet dhe mikrondërmarrjet me një konsum vjetor të pritshëm më pak se 100,000 kWh nga të licencuarit, të cilët janë të angazhuar aktivisht në veprimtarinë e furnizimit në tregun e lirë në Platformën e Krahimit të Çmimeve të krijuar nga ERE (PCT).*

3. Drejtoria e Çështjeve Konsumatore të njoftojë shoqërinë “GEN-I Tërana” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i



mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 30.12.2024, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 225, datë 30.12.2024, bëhet korrigjimi në datën e vendimit si më poshtë vijon:

Ishte:

Vendim nr. 279, datë 30.12.2024 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027”,

Bëhet

Vendim nr. 279, datë 16.12.2024 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027”.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë

